FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 193

Tiranë – E hënë, 9 nëntor 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 119/2020, datë 7.10.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar.....	13329
Ligj nr. 120/2020, datë 7.10.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar.....	13330
Ligj nr. 131/2020, datë 22.10.2020	Për ratifikimin e marrëveshjes për mbështetje teknike ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Mbështetjes dhe Prokurimit të NATO-s për realizimin e projekteve të Kuçovës, të financuara nga programi i investimeve të NATO-s për sigurinë, vitet 2019–2022.....	13337
Dekret i Presidentit nr. 11810, datë 4.11.2020	Për shpallje ligji.....	13346
Vendim i Kuvendit nr. 67/2020, datë 5.11.2020	Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit me kohë të plotë pune të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.....	13346
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 851, datë 4.11.2020	Për disa shtesa në vendimin nr. 546, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e pagave dhe shtesave mbi pagë të punonjësve të përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja, të atasheve ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe personelit civil të Ministrisë së Mbrojtjes që shërbejnë në përfaqësitë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s, në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare, të punonjësve shqiptarë për kohën që shërbejnë si nëpunës ndërlidhës pranë qendrës SECI, të punonjësve shqiptarë për kohën që shërbejnë si oficerë kontakti, pranë ministrive të brendshme homologe të shteteve të ndryshme të atashuar në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë dhe të punonjësve të Sekretariatit të Ministrisë Përgjegjëse për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural për kohën që shërbejnë si përfaqësues të kësaj ministrie pranë misionit të Republikës së Shqipërisë në Bruksel", të ndryshuar.....	13351

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 852, datë 4.11.2020	Për transferimin në pronësi të Bashkisë Kukës të njësive takuese, pjesë të pasurisë nr. 25/9, zona kadastrale 2315, dhe për disa ndryshime në vendimin nr. 167, datë 10.3.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Kukës, të qarkut të Kukësit", të ndryshuar.....	13352
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 853, datë 4.11.2020	Për transferimin në pronësi të Këshillit të Qarkut Kukës të një pjese të pasurisë nr. 23/70, ndodhur në zonën kadastrale 2315.....	13356
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 854, datë 4.11.2020	Për kalimin e përgjegjësisë së administrimit, tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të një pjese të pasurive nr. 23/69, nr. 23/70 e nr. 23/270, ndodhur në zonën kadastrale 2315, dhe për një shtesë në vendimin nr. 448, datë 16.6.2005, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi zyrës qendrore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar.....	13361
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 855, datë 4.11.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 673, datë 2.9.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë".....	13368
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 856, datë 4.11.2020	Për ndihmën financiare të disa prej kategorive kryesore të ndërmarrjeve, të cilat zbatojnë protokollet e sigurisë, në kuadër të parandalimit e të kontrollit të pandemisë COVID-19.....	13369
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 858, datë 4.11.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 349, datë 12.6.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e masave mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe erës, si dhe të procedurave për përzgjedhjen e projekteve për përfitimin e tyre".....	13375
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 859, datë 4.11.2020	Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse në zonën e Semanit, fshati Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria *"Albanian General Eletricity"* sh.a.....	13378
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 860, datë 4.11.2020	Për emërimin e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.....	13379
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 861, datë 4.11.2020	Për miratimin e ndryshimit të statusit nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, të një sipërfaqeje, në pasurinë me numër 760, zona kadastrale 3694, Bashkia Bulqizë.....	13379
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 318, datë 2.11.2020	Për delegim kompetence.....	13384

LIGJ
Nr. 119/2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 107/2014, "PËR PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E TERRITORIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,

VENDOSI:

Në ligjin nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 28, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. KKT-ja është autoriteti përgjegjës për vendimmarrjen për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi për llojet e zhvillimit komplekse, të përcaktuara në rregulloren e zhvillimit dhe ato që lidhen me çështje, zona, objekte të rëndësisë kombëtare apo me investime strategjike për interesat e vendit, si dhe për vendimmarrjen për leje zhvillimi dhe ndërtimi për objektet brenda brezit të zhvillimeve të kontrolluara, sipas përkufizimit të ligjit për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare. KKT-ja vendos miratimin e rregulloreve të veçanta për kushtet e zhvillimit për rastet në kompetencë të saj.".

Neni 2

Në nenin 38, pas pikës 2, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

"3. Për rastet të cilat shqyrtohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit, leja e zhvillimit është e detyrueshme vetëm për rastet në të cilat objekti parashikohet të ndërtohet në faza.".

Neni 3

Në nenin 39, pas pikës 4, shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

"5. Zhvilluesit, krahas dokumentacionit tekniko-ligjor, duhet të dorëzojnë edhe kontratën e sigurimit, me përfitues autoritetin publik përgjegjës për miratimin e lejes së ndërtimit. Kontrata e sigurimit duhet të mbulojë çdo dëm që mund të shkaktohet si pasojë e kryerjes së punimeve të ndërtimit në kundërshtim me lejen e ndërtimit ose lejen e zhvillimit, dokumentet e planifikimit, legjislacionin në fuqi që rregullon fushën e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, si dhe çdo shpenzim të nevojshëm e të domosdoshëm për kryerjen e punimeve të reja ose përfundimin e punimeve në rastet kur zhvilluesi nuk përfundon punimet, sipas lejes së miratuar nga autoriteti publik përgjegjës.

Shoqëria e sigurimit, në rast se ndodh ngjarja e siguruar, është e detyruar të paguajë dëmin brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së autoritetit publik përgjegjës. Në çdo rast, shuma e sigurimit duhet të jetë e barabartë me koston e parashikuar të ndërtimit të objektit, sipas preventivit përkatës.

Rregullat e detajuara për sigurimin në rastet e shkeljes së lejes së ndërtimit, sipas kësaj pike, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 4

Në nenin 41, pas pikës 1, shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

"1/1. Përjashtimisht, pavarësisht natyrës së ndërhyrjeve, të gjitha llojet e punimeve brenda zonës së brezit të zhvillimit të kontrolluar apo zonave me përparësi zhvillimin e turizmit, janë objekt i një lejeje ndërtimi të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit.".

Neni 5

Në nenin 42, në pikën 9 fjala "ndërtues" zëvendësohet me fjalën "zhvillues".

Neni 6

Në nenin 47, pika 2 ndryshohet si më poshtë :

"2. Dorëzimi i lejes së ndërtimit paraprihet nga kryerja dhe dorëzimi i sigurimit të detyrueshëm për mbulimin e përgjegjësive civile dhe profesionale, që rrjedhin nga mosrespektimi i legjislacionit në fuqi për projektimin dhe ndërtimin, për të gjithë

profesionistët e përfshirë në procesin e projektimit. Përgjegjësitë, që janë objekt sigurimi i detyrueshëm në fushën e ndërtimit, detajohen në rregulloren e zhvillimit.".

Neni 7

Në nenin 52, në pikën 1, shkronjat "e" dhe "ë" ndryshohen si më poshtë:

"e) kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror, kur ndërtimi bëhet për qëllime fitimi dhe me:

i. prishje të menjëhershme të ndërtimit pa leje në kushtet e flagrancës;

ii. prishje të punimeve të kryera pa leje kur ndërtimi pa leje rezulton si shtesë kati dhe si shtesë volumi anësor, nëse tejkalon masën 2% të sipërfaqes totale ndërtimore mbi tokë;

iii. konfiskim për interes publik apo strehim social të punimeve të kryera pa leje kur ndërtimi pa leje rezulton si shtesë kati dhe si shtesë volumi anësor, nëse tejkalon masën 2% të sipërfaqes totale ndërtimore mbi tokë, në të cilat, për shkak të qëndrueshmërisë së objektit, është e pamundur prishja e saj;

iv. konfiskim për interes publik me propozim të IKMT-së ose IMT-së dhe vendim të KKT-së të të gjithë objektit, kur ndërtimi pa leje rezulton si shtesë kati dhe si shtesë volumi anësor, nëse tejkalon masën 10% të sipërfaqes totale ndërtimore mbi tokë, kur ndërtesa është e qëndrueshme dhe është në përputhje me planet e përgjithshme, si edhe me planet e detajuara vendore;

Rregullat dhe procedurat përkatëse për konfiskimin për interes publik miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

v. kryerja e punimeve pa leje brenda brezit të zhvillimeve të kontrolluara në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, në zonat e mbrojtura apo zonën kufizuese të një monumenti kulture dënohet me 5.000.000 (pesë milionë) lekë gjobë. Lejet apo deklaratat paraprake të punimit, të miratuara në këto zona nga organet e pushtetit vendor, pa marrë paraprakisht aktin e konfirmimit nga KKT-ja, janë akte absolutisht të pavlefshme. Shkelja e kësaj rregulle nga autoritetet vendore dënohet me 2.000.000 (dy milionë) lekë gjobë;

vi. shpenzimet e prishjes dhe të pastrimit të inerteve mbulohen nga subjekti zhvillues dhe në rast të kundërt kompensohen nga konfiskimi i të ardhurave të tij, sipas faturës së prishjes e të pastrimit të inerteve nga organet shtetërore;

ë) kryerja e ndryshimeve në projekt apo e punimeve në shkelje të kushteve të lejes, pa pasoja në krijimin e shtesave në sipërfaqe dhe vëllim ndërtimor, dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 300 000 (treqind mijë) lekë, pezullim të punimeve dhe me masën e përcaktuar në përfundim të procedurës, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni.".

Neni 8
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 7.10.2020.

LIGJ
Nr. 120/2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8402, DATË 10.9.1998, "PËR KONTROLLIN DHE DISIPLINIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 2 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 2

Ky ligj zbatohet për të gjitha projektimet, zbatimet, mbikëqyrjet dhe kolaudimet e punimeve të ndërtimit, që realizohen nga persona fizikë dhe juridikë, vendës ose të huaj, në territorin e Republikës së Shqipërisë.".

Neni 2

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Punime ndërtimi" janë të gjitha punimet e ndërtimit për objektet që ndërtohen ose instalohen në territor, me vendosje të palëvizshme apo të përkohshme, që zhvillohen nën ose mbi tokë, çdo proces ndërtimi, gërmimi, prishjeje, zgjerimi, riparimi, rinovimi, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në territor.

2. "Auditim teknik" është aktekspertiza e thelluar, që vlerëson gjendjen teknike të një objekti dhe kapacitetet e tij mbajtëse.

3. "Objekte me akses publik" janë të gjitha objektet ku, pavarësisht nga statusi i pronësisë së tyre, qytetarët kanë akses të lirë hyrjeje, si: kinema, teatro, stadiume, qendra tregtare, markete dhe të tjera të ngjashme me to.

4. "Material dhe produkt ndërtimi" është çdo produkt i prodhuar për t'u përfshirë në mënyrë të përhershme në punimet e ndërtimit.

5. "Projektzbatim" është tërësia e dokumentacionit teknik, me anën e të cilit bëhet i mundur ndërtimi i plotë dhe vënia në shfrytëzim e objektit.

6. "Regjistrim i përkohshëm" është regjistrimi në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme deri në përfundim të ndërtimit të objektit, i cili është i vlefshëm për efekt të kreditimit të zhvilluesit ose të regjistrimit të kontratave paraprake.

7. "Karabina" është objekti i ndërtuar plotësisht në volum dhe në formë, sipas kushteve urbanistike të miratuara për konstruksionin dhe muraturën perimetrale të objektit.

8. "Projektues" janë të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendës apo të huaj, të licencuar për kryerjen e një veprimtarie kryesore për hartimin e projektit, në përputhje me dokumentet e planifikimit e të kontrollit të zhvillimit dhe me legjislacionin në fuqi, që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, përfshirë dispozitat antisizmike, të sigurisë, të mbrojtjes nga zjarri dhe ato higjieno-sanitare.

9. "Grup i projektimit" janë të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendës apo të huaj, të licencuar për kryerjen e një veprimtarie, që është e nevojshme për kryerjen e studimit e të projektimit, në përputhje me dokumentet e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit dhe me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, përfshirë dispozitat antisizmike, të sigurisë, mbrojtjes nga zjarri dhe higjieno-sanitare.

10. "Mbikëqyrës i punimeve" është personi fizik ose juridik, vendës apo i huaj, i licencuar për ushtrimin e mbikëqyrjes së punimeve, i cili ka përgjegjësi kontrollin e mbarëvajtjes së të gjithë procesit të zbatimit të punimeve, në përputhje me projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, grafikun e punimeve, si dhe destinacionin e objektit, duke pasur parasysh edhe anën ekonomike të tij.

11. "Zbatues i punimeve" është personi juridik, vendës apo i huaj, i licencuar për të ushtruar veprimtari në zbatimin e punimeve të ndërtimit, sipas klasifikimeve dhe kategorive të punimeve që ka të përcaktuar në licencë, i cili është përgjegjës për realizimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik.

12. "Drejtues teknik" është personi fizik, i përcaktuar në licencën e shoqërisë, i cili është përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me projektin, preventivin, specifikimet teknike, standardet dhe grafikun e miratuar, deri në kolaudimin e objektit.

13. "Kolaudator" është personi fizik ose juridik, vendës apo i huaj, i licencuar, i cili pas përfundimit të punimeve të ndërtimit është përgjegjës për kontrollin e përputhshmërisë së punimeve të zbatimit të projektit me kushtet e lejes së ndërtimit, me standardet e rregullat teknike, si dhe me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

14. "Zhvillues" është çdo person fizik ose juridik, që investon dhe realizon një zhvillim në një zonë ose njësi ku lejohet zhvillimi.

15. "Regjistri elektronik i profesionistëve të regjistruar" është baza e të dhënave shtetërore për të gjithë profesionistët e licencuar në fushën e studimit, projektimit, zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit, pavarësisht nëse janë të regjistruar si persona fizikë ose shoqëri tregtare dhe realizon paraqitjen e informacionit për licencimin, veprimtarinë dhe masat disiplinore në fuqi për të gjitha subjektet.".

Neni 3

Në nenin 5, paragrafi i dytë shfuqizohet.

Neni 4

Pas nenit 5 shtohet neni 5/1, me këtë përmbajtje:

"Neni 5/1
Përgjegjësia e projektuesit

1. Projektuesi është përgjegjës për hartimin e studimeve e të projekteve, në përputhje me detyrën e projektimit, me dokumentet e planifikimit e të kontrollit të zhvillimit dhe me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, përfshirë dispozitat antisizmike, të sigurisë, mbrojtjes nga zjarri, higjieno-sanitare, si dhe eficiencën energjetike.

2. Projektuesi ose grupi i projektimit është përgjegjës për kontrollin e përputhshmërisë së dokumenteve dhe studimeve të përgatitura nga çdo projektues, pjesë e grupit të projektimit, me detyrën e projektimit, me dokumentet e planifikimit e të zhvillimit, me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, përfshirë dispozitat antisizmike, të sigurisë, mbrojtjes nga zjarri, higjieno-sanitare, si dhe eficiencën energjetike.

3. Çdo projektues ose grup projektimi është i detyruar të lidhë një kontratë të sigurimit të përgjegjësisë profesionale për çdo dëm që mund të shkaktohet si pasojë e veprimtarisë së tij dhe duhet të mbulojë të paktën dëmet e mëposhtme:

a) çdo shpenzim të nevojshëm e të domosdoshëm të projektimit të ri, si dhe shpenzimet shtesë të kryera nga zhvilluesi ose organet e administratës publike, që kanë rrjedhur si pasojë e gabimeve në projektim;

b) kostot shtesë që mund të lindin për zhvilluesin, si pasojë e gabimeve në projektim gjatë zbatimit të projektit.".

Neni 5

Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 6

1. Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha:

a) ndërtimet publike;

b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë;

c) objektet me akses publik.

2. Për çdo rast, institutet shtetërore ose entet e tjera, që kryejnë oponencën teknike, janë solidarisht përgjegjëse me projektuesin për çdo dëm që rrjedh, si pasojë e gabimeve ose të metave të oponencës teknike, si dhe mbajnë përgjegjësi administrative ose penale, sipas rastit, për shkeljen e legjislacionit në fuqi.

Rregullat për projektet, që duhet t'i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 6

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 7

1. Për të gjitha llojet e objekteve duhet të vendoset detyrimisht mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve. Mbikëqyrësi i punimeve/grupi i mbikëqyrësve caktohet nga zhvilluesi.

2. Në rastet kur autoritetet publike investojnë dhe realizojnë një zhvillim në një zonë të caktuar, mbikëqyrësi i punimeve/grupi i mbikëqyrësve përzgjidhet nga autoriteti publik në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për prokurimin publik.".

Neni 7

Pas nenit 7 shtohet neni 7/1, me këtë përmbajtje:

"Neni 7/1
Përgjegjësia e mbikëqyrësit

1. Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit. Kur mbikëqyrësi i punimeve konstaton raste të ndryshimit të projektit, është i detyruar të njoftojë menjëherë Inspektoratin Vendor të Mbrojtjes së Territorit të bashkisë.

2. Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve, në çdo rast, kur gjatë mbikëqyrjes së punimeve, sipas fazave përkatëse, konstaton mospërputhjen e punimeve të kryera me lejen e ndërtimit, me dokumentet e planifikimit e të kontrollit të zhvillimit dhe me legjislacionin në fuqi, që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, urdhëron pezullimin e punimeve të ndërtimit dhe njofton menjëherë Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit të bashkisë ku kryhen punimet e ndërtimit dhe autoritetin përgjegjës të planifikimit ose, sipas rastit, edhe Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.

3. Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit ose, sipas rastit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit ushtron kontrollin jo më vonë se 15 ditë nga data e marrjes së njoftimit, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme.

4. Zbatuesi i punimeve mund të rifillojë punimet e ndërtimit vetëm pasi të jenë marrë të gjitha masat përkatëse, të jetë paguar çdo detyrim administrativ i vendosur nga inspektorati, si dhe autoriteti përgjegjës i planifikimit të territorit të ketë miratuar ndryshimin e projektit, në rastet kur kjo është në përputhje me legjislacionin për planifikimin e territorit.

5. Mbikëqyrësi i punimeve ose shoqëria e licencuar për mbikëqyrjen e punimeve është e detyruar të lidhë një kontratë të sigurimit të përgjegjësisë profesionale për çdo dëm që mund të shkaktohet si pasojë e veprimtarisë së tij.

6. Këshilli i Ministrave, me vendim, përcakton rregullat e detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale të mbikëqyrësit, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve.".

Neni 8

Neni 8 ndryshohet, si më poshtë:

"Neni 8

1. Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendës apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimore.

2. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit, në përputhje me standardet kombëtare ose evropiane.

3. Çdo zbatues punimesh është i detyruar të lidhë një kontratë të sigurimit të përgjegjësisë profesionale për çdo dëm që mund të shkaktohet si pasojë e veprimtarisë së tij dhe duhet të mbulojë të paktën çdo shpenzim të nevojshëm e të domosdoshëm për kryerjen e punimeve të reja, si dhe shpenzimet shtesë të kryera nga zhvilluesi ose organet e administratës publike, që kanë rrjedhur si pasojë e zbatimit të punimeve në kundërshtim me kontratën përkatëse për zbatimin e punimeve të ndërtimit, me dokumentet e planifikimit dhe zhvillimit, si dhe me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e ndërtimit.

4. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi për dëmet që shkaktohen në infrastrukturën publike gjatë zbatimit të punimeve të ndërtimit.

5. Zhvilluesi i punimeve duhet të kryejë siguracionin për dëmtim kundrejt palëve të treta në infrastrukturën publike.

6. Mbikëqyrësi i punimeve, me konstatimin e dëmtimit kundrejt palëve të treta në infrastrukturën publike, urdhëron pezullimin e punimeve të ndërtimit dhe njofton menjëherë Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit të bashkisë ku kryhen punimet e ndërtimit ose, sipas rastit, edhe Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, zhvilluesin dhe sipërmarrësin për dëmin e shkaktuar, si dhe shkallën e tij.

7. Zbatuesi i punimeve mund të rifillojë punimet e ndërtimit vetëm pasi të jenë konfirmuar nga mbikëqyrësi dhe miratuar nga zhvilluesi riparimet e dëmeve të shkaktuara, si dhe zhdëmtimi financiar i palës së dëmtuar për periudhën e riparimit.

8. Në rast të mosrealizimit në kohë të dëmit të shkaktuar, zbatuesi i punimeve u nënshtrohet masave për shkeljet disiplinore të përcaktuara në nenin 14/4 të këtij ligji.

9. Kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale të projektuesit, të grupit të projektimit dhe zbatuesit të punimeve, si dhe rregullat dhe procedurat e sigurimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 9

Pas nenit 8 shtohet neni 8/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 8/1
Drejtuesi teknik

1. Drejtuesi teknik është solidarisht përgjegjës me zbatuesin e punimeve për të realizuar punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik.

2. Drejtuesi teknik nuk mban përgjegjësi solidare, sipas pikës 1 të këtij neni, vetëm kur njofton menjëherë Inspektoratin Vendor të Mbrojtjes së Territorit ose, sipas rastit, Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, si dhe mbikëqyrësin e punimeve në rastet kur kryhen punime në kundërshtim me lejen e ndërtimit/lejen e zhvillimit, dokumentet e planifikimit e të kontrollit të zhvillimit dhe me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë.

3. Drejtuesi i punimeve është pjesë e stafit të zbatuesit të punimeve i përcaktuar në licencën e shoqërisë.”.

Neni 10

Në nenin 9, në paragrafin e dytë, shkronja “a”, fjalia “Me projektzbatim kuptohet tërësia e dokumentacionit teknik, me anën e të cilit bëhet i mundur ndërtimi i plotë dhe vënia në shfrytëzim e objektit” shfuqizohet.

Neni 11

Në nenin 12/1, paragrafi i dytë dhe paragrafi i tretë shfuqizohen.

Neni 12

Pas nenit 14 shtohet neni 14/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 14/1
Regjistri elektronik i profesionistëve të licencuar

1. “Regjistri elektronik i profesionistëve të licencuar” është një bazë të dhënash shtetërore, që krijohet dhe administrohet nga ministria përgjegjëse për ndërtimin.

2. “Regjistri elektronik i profesionistëve të licencuar” ka si qëllim të regjistrojë të gjitha të dhënat parësore e dytësore për profesionistët e licencuar, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e planifikimit, zhvillimit dhe disiplinimit të punimeve të ndërtimit.

3. Këshilli i Ministrave miraton rregulla të detajuara për të dhënat parësore dhe dytësore, që regjistrohen në regjistrin elektronik, për dhënësit e informacionit, për ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave, si dhe për nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara.”.

Neni 13

Pas nenit 14/1 shtohet kreu II/1, me këtë përmbajtje:

"KREU II/1
PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE

Neni 14/2
Rregullat për përgjegjësinë disiplinore

1. Projektuesit, zbatuesit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorët kanë përgjegjësi disiplinore nëse me veprime ose mosveprime gjatë ushtrimit të veprimtarisë profesionale kryejnë një nga shkeljet e përcaktuara në nenin 14/4 të këtij ligji.

2. Përgjegjësia për kryerjen e një vepre penale ose administrative, sipas rastit, nuk përjashton përgjegjësinë disiplinore sipas këtij ligji.

3. Rregullat për fillimin e procedurës disiplinore, të drejtat dhe detyrimet e subjektit gjatë procedurës disiplinore, për caktimin e masave disiplinore dhe çdo çështje tjetër që lidhet me procedurat disiplinore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 14/3
Përgjegjësia e zhvilluesit

1. Zhvilluesi është solidarisht përgjegjës me projektuesin, zbatuesin, mbikëqyrësin dhe kolaudatorin e punimeve të ndërtimit për projektimin dhe kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, me dokumentet e planifikimit e kontrollit të zhvillimit dhe me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, përfshirë dispozitat antisizmike, të sigurisë, të mbrojtjes nga zjarri, higjieno-sanitare, si dhe eficiencën energjetike.

2. Zhvilluesi është i detyruar të njoftojë menjëherë Inspektoratin Vendor të Mbrojtjes së Territorit ose, sipas rastit, Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, në rastet kur kryhen punime në kundërshtim me lejen e ndërtimit, me dokumentet e planifikimit e kontrollit të zhvillimit dhe me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë.

3. Në rast se zhvilluesi kryen zhvillimin e zonës ose njësisë përkatëse si pjesë e veprimtarisë së tij tregtare, me qëllim shitjen ose transferimin e titullit të pronësisë së objekteve ose njësive individuale të ndërtuara palëve të treta dhe ndërtimi është kryer në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji ose legjislacionin në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, zhvilluesi përjashtohet nga e drejta për të marrë leje zhvillimi ose ndërtimi nga autoritetet përgjegjëse për 5 vjet. Bashkitë publikojnë listën e zhvilluesve që kanë kryer ndërtimet në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe afatin gjatë të cilit janë të përjashtuar nga e drejta për të marrë leje zhvillimi ose ndërtimi.

Neni 14/4
Shkeljet disiplinore

1. Përbën shkelje disiplinore, sipas këtij ligji, kryerja e veprimeve ose mosveprimeve të mëposhtme:

a) përgatitja e studimeve ose e projektimeve në kundërshtim me standardet teknike në fuqi ose paraqitja pranë autoriteteve publike e studimeve ose e projektimeve me të meta më shumë se një herë;

b) kryerja e projektit të zbatimit, duke u bazuar në studime që dukshëm paraqesin të meta, si dhe ushtrimi përgjithësisht i detyrës me pakujdesi në atë masë që mund të paraqesë rrezik për shëndetin dhe sigurinë publike, mjedisin ose trashëgiminë kulturore;

c) kryerja e punimeve të zbatimit me pakujdesi në shkelje të normave teknike ose praktikave të mira, si dhe në shkelje të legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, disiplinimin e punimeve të ndërtimit apo sigurinë në punë;

ç) mospërmbushja e rregullt e detyrave sipas legjislacionit në fuqi për mbikëqyrjen e ndërtimeve ose mosnjoftimi i organeve shtetërore përgjegjëse për shkeljet e kryera nga zbatuesi i punimeve;

d) kolaudimi i objekteve në kundërshtim me legjislacionin në fuqi;

dh) kryerja e veprimeve ose mosveprimeve, që sjellin dëmtimin e reputacionit të profesionit, në kundërshtim me rregullat e etikës të miratuara me urdhër të ministrit përgjegjës për ndërtimin.

2. Shkelje disiplinore janë edhe veprimet ose mosveprimet që përbëjnë vepër penale, pavarësisht faktit nëse vepra penale është shlyer, ndjekja penale nuk është filluar ose nuk mund të vazhdojë, subjekti i licencuar është rehabilituar ose ka përfituar nga falja apo amnistia, me kushtin që nuk kanë kaluar më shumë se 5 vjet nga momenti i shkeljes.

Neni 14/5
Komisioni disiplinor

1. Komisioni disiplinor është një organ *ad-hoc* për ecurinë e procedurës disiplinore dhe për evidentimin e ekzistencës së shkeljes disiplinore dhe masën përkatëse të saj. Ky komision mbështetet administrativisht nga ministria përgjegjëse për ndërtimin, e cila cakton brenda strukturës së saj edhe drejtorinë përgjegjëse për ushtrimin e funksionit të sekretarisë së komisionit disiplinor.

2. Përbërja dhe numri i anëtarëve të komisionit disiplinor, mënyra e funksionimit dhe masa e shpërblimit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për ndërtimin.

3. Mandati i anëtarëve të komisionit disiplinor është 5 vjet, pa të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme.

4. Anëtarët e komisionit disiplinor duhet të jenë të pavarur e të paanshëm në vendimmarrjen e tyre.

5. Anëtarët e komisionit disiplinor duhet të tërhiqen nga shqyrtimi i çështjeve kur ata kanë konflikt interesi apo kur ka dyshime për paanësinë e tyre, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 14/6
Propozimi për fillimin e procedurës disiplinore

1. Propozimin për fillimin e procedurës disiplinore mund ta paraqesë zhvilluesi, inspektorati vendor ose kombëtar, kryetari i bashkisë, në rastet kur ndërtimi është kryer në territorin e bashkisë, çdo autoritet publik që mbikëqyr veprimtarinë e ndërtimit ose çdo person fizik ose juridik.

2. Propozimi për fillimin e procedurës disiplinore i drejtohet komisionit disiplinor nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për ndërtimin.

Neni 14/7
Procedura disiplinore

1. Pas marrjes së propozimit për fillimin e procedurës disiplinore, ministria përgjegjëse për ndërtimin e regjistron atë dhe brenda 5 ditësh ia dërgon komisionit disiplinor.

2. Komisioni disiplinor:

a) kryen hetimin disiplinor për propozimin për fillimin e procedurës disiplinore;

b) përcakton datën e seancës dëgjimore, e cila duhet të jetë jo më vonë se 15 ditë nga data e marrjes së propozimit për fillimin e procedurës disiplinore;

c) njofton palët për zhvillimin e seancës dëgjimore të paktën 10 ditë përpara.

3. Komisioni disiplinor e zbaton procedurën për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore të subjektit të licencuar dhe cakton masat disiplinore të përshtatshme, sipas përcaktimeve të këtij ligji, si dhe akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e subjektit të licencuar.

4. Këshilli i Ministrave miraton rregulla të detajuara për zhvillimin e procedurës disiplinore, afatet dhe të drejtat e palëve gjatë kësaj procedure.

Neni 14/8
Masat disiplinore

1. Për shkelje të dispozitave që rregullojnë ushtrimin e profesionit dhe veprimtarinë e projektuesit, zbatuesit, mbikëqyrësit, drejtuesit teknik dhe kolaudatorit u jepen masat disiplinore të mëposhtme:

a) paralajmërim me shkrim;

b) vërejtje me paralajmërim për heqjen e licencës për ushtrimin e profesionit;

c) urdhërimin e subjektit për të kryer trajnim shtesë, përfshirë trajnim në etikë profesionale dhe/ose trajnim në një fushë të veçantë të veprimtarisë profesionale;

ç) pezullim nga detyra për një periudhë nga një deri në pesë vjet;

d) heqje përfundimtare e licencës për ushtrimin e profesionit.

2. Masat disiplinore arsyetohen dhe merren sipas një procedure transparente dhe jepen në proporcion me shkeljen dhe bazohen në kriteret e mëposhtme:

a) shkallën e pakujdesisë;

b) shpeshtësinë e kryerjes së shkeljes;

c) probabilitetin dhe rëndesën e dëmit të mundshëm nga shkelja.

3. Subjekti, që ka paraqitur propozimin për fillimin e procedurës disiplinore, ministri përgjegjës për ndërtimin ose subjekti ndaj të cilit është marrë një masë disiplinore sipas këtij ligji, ka të drejtë të

ankimojë në gjykatën kompetente administrative çdo vendim të komisionit disiplinor.

4. Ankimi kundër vendimit të komisionit disiplinor nuk pezullon zbatimin e vendimit të ankimuar.”.

Neni 14

Në nenin 15 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Shkeljet e neneve 4, 5, 6, 7 e 8 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me dënim kryesor me gjobë në masën 1.000.000 (një milion) deri në 3.000.000 (tre milionë) lekë.”.

2. Në pikën 5, togfjalëshi “organeve përkatëse” zëvendësohet me togfjalëshin “komisionit disiplinor” dhe togfjalëshi “heqjen e licencës” zëvendësohet me togfjalëshin “marrjen e masës disiplinore ndaj”.

Neni 15
Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve: 6, pika 2; 7/1, pika 6; 8, paragrafi 9; 14/1, pika 3; 14/2, pika 3; 14/5, pika 2; 14/7, pika 4, të ligjit.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 7.10.2020.

LIGJ
Nr. 131/2020

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR MBËSHTETJE TEKNIKE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE AGJENCISË SË MBËSHTETJES DHE PROKURIMIT TË NATO-s PËR REALIZIMIN E PROJEKTEVE TË KUÇOVËS, TË FINANCUARA NGA PROGRAMI I INVESTIMEVE TË NATO-s PËR SIGURINË, VITET 2019–2022

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja për mbështetje teknike ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Mbështetjes dhe Prokurimit të NATO-s për realizimin e projekteve të Kuçovës, të financuara nga programi i investimeve të NATO-s për sigurinë, vitet 2019–2022”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 22.10.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11810, datë 4.11.2020, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

NATO E PAKLASIFIKUAR

MARRËVESHJE PËR MBËSHTETJE TEKNIKE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE AGJENCISË SË MBËSHTETJES DHE PROKURIMIT TË NATO-s PËR REALIZIMIN E PROJEKTEVE TË KUÇOVËS TË FINANCUARA NGA PROGRAMI I INVESTIMEVE TË NATO-s PËR SIGURINË,
VITET 2019–2022

REFERENCAT

A. AC/4 (PP)D/27931-REV1 (INV), e datës 11 shkurt 2019

B. AC/4 (PP)N(2019)0044 (INV)

C. Letra nr. 7355 prot. e datës 8 tetor 2019

D. AC/4 (PP)N(2019) 0038 (INV)

1. NENI I – QËLLIMI

1.1 Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje për Mbështetje Teknike (TSA) është vendosja e kuadrit teknik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (ALB MOD ose brenda kësaj TSA-je, gjithashtu si HN ALB) dhe Agjencisë së NATO-s për Mbështetjen dhe Prokurimin (NSPA) - në vijim së bashku të referuar si "Pjesëmarrësit" - për përfundimin e shërbimeve të projektimit dhe të ndërtimit pasues të mjediseve në mbështetje të disa projekteve të financuara nga Programi i Investimeve të NATO-s për Sigurinë (NSIP), ku NSPA-ja është autorizuar nga Komiteti i Investimeve për të vepruar si "Agjenci në emër të HN-së"[1].

1.2 Komisioni i Investimeve (IC), në referencën A, paraqet kërkesat për projektet së bashku me konfirmimin që NSPA-ja është "Shteti i autorizuar në emër të HN Albania", në mbështetje të HN-së në përgatitjen e 35% të projektit dhe vlerësimit të shpenzimeve të tipit B (TBCE).

1.3 Në Referencën C, HN Albania informon Zyrën e NATO-s për Burimet (IS/NOR) mbi synimin për të vazhduar me mbështetjen e NSPA-së për zbatimin, duke përfshirë projektin përfundimtar dhe punimet e ndërtimit.

2. NENI 2 – OBJEKTI

2.1 Objekti i kësaj TSA-je është përftimi dhe menaxhimi i shërbimeve të projektimit dhe të punimeve të ndërtimit për projektet e renditura më poshtë, kur autorizohen nga IC-ja.

Tabela 1. Fondet e autorizuara për serial

NSIP serial	Përshkrimi	Financimi i alokuar
3AF10005-0	Restaurimi i kullës së kontrollit	100,000 euro
3AF10007-0	Sigurimi i mjediseve për depozitimin dhe furnizimin me karburant për avionët	8,545,000 euro
3AF10009-0	Sigurimi i mjediseve për municionin	2,000,000 euro
3AF10010-0	Sigurimi i qendrës kundër avarive dhe zjarrit	672,000 euro
3AF10011-0	Restaurimi i pistës	30,000,000 euro

2.2 Me marrëveshje të ndërsjellë me shkrim të të dy Pjesëmarrësve, NSPA-ja mund të pranojë objekt shtesë brenda nenit 2 të kësaj TSA-je, nëse kërkohet nga HN ALB-ja dhe miratohet nga IC-ja.

2.3 Objekti shtesë për projektet, i financuar me financime kombëtare dhe/ose projekte shtesë, tej asaj të autorizuar nga IC-ja, mund të kërkohet nga HN ALB-ja për t'u përfshirë brenda nenit 2 të kësaj TSA-je, sipas kushteve të direktivës funksionale 252 (shtojca 1).

3. NENI 3 – FILLIMI I PROJEKTIT

3.1 NSPA-ja do të fillojë me përftimin dhe menaxhimin e shërbimeve të projektimit dhe punimet e ndërtimit, në mbështetje të projekteve të punëve civile NSPI, pasi IC-ja të miratojë NSPA-në si "Agjenci në emër të HN-së".

[1] Agjencia në emër të HN-së (në vijim i referuar si "Shteti i autorizuar" konsiderohet të jetë agjencia përgjegjëse për përftimin dhe administrimin e shërbimeve teknike dhe të prokurimeve, më emër të HN-së së autorizuar, që merr përgjegjësinë financiare për fondet e autorizuara nga IC-ja (duke përfshirë CIRIS, parashikimet financiare dhe raportimin sipas afateve). Të gjitha përgjegjësitë e tjera të HN-së i mbeten HN-së, sipas autorizimit nga IC-ja.

4. NENI 4 – PËRGJEGJËSITË PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT

4.1 HN ALB-ja mbetet përgjegjëse ndaj IC-së për bashkërendimin e përgjithshëm dhe realizimin e projekteve NSIP, gjatë gjithë kohëzgjatjes së zbatimit të projektit deri në autorizimin e suksesshëm dhe pranimin.

4.2 IC-ja e autorizon NSPA-në të jetë "Agjencia në emër të HN-së" që lejon financimin e NSIP-së të menaxhohet dhe të shpenzohet nga NSPA-ja. Në referencën A jepet konfirmimi.

4.3 NSPA-ja do të marrë përgjegjësi për përftimin dhe menaxhimin e shërbimeve të projektimit dhe punimet e ndërtimit, sipas rregulloreve të prokurimit të NSPA-së për projektet, sipas parashikimit të nenit 3 të kësaj TSA-je.

4.4 HN ALB-ja dhe NSPA-ja i raportojnë IC-së për të gjitha çështjet në lidhje me zbatimin e projekteve të NSIP-së, në pajtim me rolet dhe përgjegjësitë e renditura në nenin 5 të kësaj TSA-je.

5. NENI 5 – ROLET DHE PËRGJE-GJËSITË

5.1 HN ALB-ja (i përfaqësuar nga Departamenti i Politikave të Investimeve për Mbrojtjen dhe Logjistikës) do të jetë përgjegjës, për:

5.1.1 Të vepruar si Koordinator Teknik i Projektit[2] gjatë gjithë fazave të projektimit të projektit, zbatimit, autorizimit dhe pranimit.

5.1.2 Ngritjen e një strukture të bashkërendimit teknik/kërkesave të projektit, siç tregohet në aneksin A të kësaj TSA-je, me qëllim që të bashkërendohen dhe të drejtohen aktivitetet e të gjithë aktorëve të interesuar.

5.1.3 Rishikimin dhe pranimin e propozimit të specifikimeve teknike të NSPA-së për projektet e renditura në tabelën 1 të kësaj TSA-je.

5.1.4 Thirrjen dhe kryesimin e mbledhjeve mbi progresin/rishikimin, brenda kuadrit të strukturës së bashkërendimit teknik të projektit të dhënë në aneksin A, veçanërisht në lidhje me:

5.1.4.1 Rishikimin dhe miratimin e të gjitha ndryshimeve në projekt që kanë ndikim në objekt, shpenzime ose kohë.

5.1.4.2 Rishikimin në takime periodike të menaxhimit financiar të projektit.

5.1.4.3 Rishikimin dhe miratimin e të gjitha ndryshimeve në terren që kanë ndikim në objekt, shpenzime ose kohë.

5.1.4.4 Kërkimin e bashkëpunimit të aktorëve për të garantuar që kërkesat të përkufizohen, miratohen dhe regjistrohen siç duhet.

5.1.4.5 Kërkimin e bashkëpunimit me subjektet kombëtare dhe ushtarake për të lehtësuar punët dhe për të zgjidhur problemet, gjatë fazave të projektimit, zbatimit, autorizimit dhe pranimit.

5.1.5 Paraqitjen e kërkesave për objektin dhe fondet tek IC-ja, të mbështetura nga NSPA-ja.

5.1.6 Lehtësimin e marrjes së të gjitha lejeve të nevojshme kombëtare (standardet e kërkuara ALB etj.). ALB MOD do të zhvillojë procedurën për marrjen e miratimit të projektit dhe të lejeve të ndërtimit.

5.1.7 Veprimin si ndërmjetës midis NSPA-së dhe organeve kombëtare, sipas rastit.

5.1.8 Sipas rastit, këshillimin mbi legjislacionin shqiptar që kërkohet të përmbushet nga kontraktuesit, para Ofertës Konkurruese Ndërkombëtare.

5.1.9 Praninë dhe sigurimin e pranisë së të gjithë përfaqësuesve të autorizuar që kërkohen për të zhvilluar procedurat e autorizimit dhe të pranimit për pajisjet e plotësuara.

5.1.10 Marrjen e të gjitha masave të nevojshme për të garantuar që të gjitha mallrat/materialet/pajisjet e sjella në territorin e Republikës së Shqipërisë për përmbushjen e objektit të Marrëveshjes së Mbështetjes Teknike, do të përjashtohen nga TVSH-ja, detyrimet doganore dhe taksat e tjera.

5.2 NSPA-ja do të jetë përgjegjëse për sa më poshtë:

5.2.1 Zhvillimin e aktiviteteve të menaxhimit të projektit brenda objektit dhe fondeve të autorizuara, në pajtim me punët e miratuara nga IC-ja për projektet e NSIP-së. Veçanërisht:

5.2.1.1 përftimin dhe menaxhimin e shërbimeve arkitekturore dhe inxhinierike (A&E) për të zhvilluar ose për të finalizuar projektet, në

[2] Koordinatori Teknik i Projektit konsiderohet të ketë të gjitha përgjegjësitë e HN-së të nevojshme për zbatimin e projektit të investimit për sigurinë (sipas përkufizimit në AC/4-D/2261-1996 ed.), përveç përgjegjësive të prokurimit të deleguara "Agjencisë në emër të HN-së" dhe përgjegjësive të NSPA-së te 5.2.

pajtim me autorizimin e IC-së dhe ligjet dhe rregulloret shqiptare;

5.2.1.2 përftimin dhe menaxhimin e mbikëqyrësve të kualifikuar për ndërtimin nga palët e treta, të cilat kërkohen sipas ligjit dhe rregullohet shqiptare për ndërtimin;

5.2.1.3 përftimin dhe menaxhimin e shërbimeve të ndërtimit, në pajtim me autorizimin e IC-së dhe ligjet dhe rregulloret shqiptare;

5.2.1.4 sigurimin e menaxhimit të kontrollit të ndryshimit gjatë fazave të finalizimit të projektit dhe zbatimit, komisionimit dhe pranimit;

5.2.1.5 sigurimin e përfshirjes së garancive/ obligacioneve në të gjitha kontratat e ndërtimit, në pajtim me pëlqimin e HN ALB-së për vlerën dhe kohëzgjatjen e këtyre garancive dhe miratimin e tyre nga IC.

5.2.2 Paraqitjen e raporteve periodike për projektin te HN ALB-ja (Koordinatori Teknik i Projektit), me qëllim që HN ALB-së t'i mundësohet mbikëqyrja e zbatimit të projektit.

5.2.3 Hartimin e raporteve specifike të projektit për HN ALB-në (Koordinatori Teknik i Projektit) për t'ia paraqitur rregullisht IC-së.

5.2.4 Rekomandimin e çdo ndryshimi teknik të nevojshëm në projekt te Koordinatori Teknik i Projektit për shqyrtim.

5.2.5 Pjesëmarrjen në mbledhjet mbi progresin/rishikimin e projektit me Koordinatorin Teknik të Projektit, duke u përqendruar në ofrimin e të dhënave të kërkuara teknike dhe afateve.

5.2.6 Hartimin e kërkesave mbi objektin, fondet dhe dokumentet e tjera të projektit për HN ALB-në (Koordinatori Teknik i Projektit) për t'ia paraqitur rregullisht IC-së.

5.2.7 Vendosjen e të gjithë dokumentacionit të projektit të zbatueshëm për "Agjencinë në emër të HN-së" te CIRIS.

5.2.8 Raportimin e të gjithë informacionit të zbatueshëm mbi afatet dhe financiar "Agjencia në emër të HN-së" tek IC-ja (nëpërmjet CIRIS), duke mbajtur të informuar HN ALB-në (Koordinatori Teknik i Projektit).

5.2.9 Hartimin e dokumentacionit dhe mbështetjes për kërkesat teknike pasuese për operimin dhe mirëmbajtjen, sipas kërkesës.

5.2.10 Asistimin e mbylljes së projektit në pajtim me rregulloret e NSIP-së (JFAI, të tjera).

5.2.11 NSPA-ja do të garantojë që kushtet e garancisë të përfshihen në kontratat e ndërtimit. Kushtet e garancisë duhet të miratohen nga HN ALB-ja dhe IC-aja. Kushtet dhe procedurat e përgjithshme që synon të zbatojë NSPA-ja paraqiten në aneksin D.

5.2.12 NSPA-ja do të dërgojë informacion në lidhje me kontraktuesit shqiptarë që do të ofertojnë për përmbushjen e objektit të Marrëveshjes së Mbështetjes Teknike, i cili duhet të certifikohet nga autoritetet kompetente të MM-së shqiptare, për të qenë të përshtatshëm për t'u përfshirë në listën e burimeve të NSPA-së. Nëse kontraktuesit përdorin nënkontraktues shqiptarë, atëherë pranohet se të gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të aplikojnë te MM-ja shqiptare në pajtim me nenin 45, në ligjin numër 9643, datë 20.11., "Prokurimet publike" dhe që do të vleftësohet nga MM-ja shqiptare. Me qëllim lehtësimin e vleftësimeve të tilla në kohë dhe si rrjedhojë maksimizimin e konkurrencës, Shqipëria do të kryejë vleftësimin e aplikimeve në një kohë të shpejtë dhe NSPA-ja do të udhëzojë ofertues të mundshëm se nënkontraktuesit nga Shqipëria duhet t'i nënshtrohen vlerësimit pozitiv në kohën e paraqitjes së ofertës.

5.2.13 NSPA-ja ia jep kontratën ofertuesit më të ulë teknik të pranueshëm që caktohet nga një proces ndërkombëtar i ofertimit konkurrues (ICB), në pajtim me Rregulloret e Prokurimit të NSPA-së.

6. NENI 6 – AFATET E PROJEKTIT

6.1 Afatet për zbatimin e projekteve jepen në aneksin B.

6.2 Çdo ndryshim i propozuar për afatet e projektit të dhëna në aneksin B do t'i paraqiten IC-së nga HN ALB, mbështetur nga NSPA-ja.

7. NENI 7 - MASAT FINANCIARE

7.1. Buxheti Operativ: Buxheti operativ për të mbuluar projektimin, kontrollin e ndërtimit dhe shërbimet e ndërtimit do të jetë sipas përcaktimit në dokumentet e autorizimit të IC-së. Pasi IC-ja të ketë miratuar NSPA-në si "Agjencia në emër të HN-së"', menaxhimi i fondeve do të jetë ndërmjet IC-së dhe NSPA-së në pajtim me rregulloret dhe procedurat e NSIP-së.

7.2 Kostoja e menaxhimit të projektit

7.2.1 Kostoja e parashikuar e NSPA-së e menaxhimit të projektit për përftimin dhe

menaxhimin e projekteve të HSIP-së jepet në aneksin C të kësaj TSA-je.

7.2.2 Kostoja e PMC-së e dhënë në aneksin C duhet të përfshihet në kërkesën e NSPA-së si "Agjencia në emër të HN-së"" drejtuar IC-së për të autorizuar Fondet e Planifikimit të Avancuar për fillimin dhe menaxhimin e projekteve NSIP.

8. NENI 8 – MOSMARRËVESHJET

8.1 Në rastin e një mosmarrëveshjeje, keqkuptimi apo vështirësie tjetër që rrjedh nga ekzekutimi gjatë zbatimit të kësaj TSA-je, Pjesëmarrësit do të bëjnë përpjekjet e tyre maksimale për të arritur një zgjidhje me pajtim. Ky parashikim nuk parandalon prishjen e kësaj marrëveshjeje me pëlqim të ndërsjellë të Pjesëmarrësve në pajtim me seksionin 10.2

9. NENI 9 – NDRYSHIMET

9.1 Objekti i kësaj TSA-je mund të ndryshohet në formën e një aneksi ndryshues, me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të të dy Pjesëmarrësve.

9.2 Kjo TSA mund të ndryshohet në çdo kohë me shkrim nga Pjesëmarrësit.

10. NENI 10 - HYRJA NË FUQI, KOHËZGJATJA DHE PRISHJA

10.1 Për NSPA-në kjo TSA do të hyjë në fuqi datën e nënshkrimit të fundit dhe do të mbetet në fuqi deri në përfundimin dhe përmbushjen e projekteve të financuara nga NSIP-së.

10.2 Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë, kjo TSA do të hyjë në fuqi pasi të bëhet lajmërimi, që kjo e fundit ka përfunduar procedurat e veta të brendshme ligjore.

10.3 Kjo TSA mund të prishet me pëlqimin e ndërsjellë të të dy Pjesëmarrësve.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës
së Shqipërisë

Datë

Për NSPA-në:
LK Menaxher Programi

Datë

ANEKSET

A. Projektet NSPI - Struktura e bashkërendimit teknik të propozuar

B. Afatet e projektit

C. Shpenzimet e menaxhimit të projektit të NSPA-së

D. Garancia

BASHKËLIDHUR:

1. DIREKTIVA FUNKSIONALE NAMSO NR. 252, DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PËR SHITJET

NATO E PLASTIFIKUAR

ANEKSI A I NSPA ALB TSA Vitet 2019-2022, dhjetor 2018

ANEKSI A - STRUKTURA E BASHKËRENDIMIT TEKNIK



ANEKS B
AFATET E PROJEKTIT

NSIP Serial	Përshkrimi	Afatet					
		Shteti i autorizuar NSPA & APF	TBCE Paraqitur	IFB	CA	EDC	JFAI
3AF10005-0	Restaurimi i kullës së kontrollit	1 muaj	7 muaj	4 muaj	7 muaj	21 muaj	6 muaj
	Data e pritshme	shkurt 2019	shtator 2019	Janar 2020	gusht 2020	maj 2022	nëntor 2022
3AF10007-0	Sigurimi i mjediseve për depozitimin dhe furnizimin me karburant për avionët	1 muaj	7 muaj	4 muaj	7 muaj	33 muaj	6 muaj
	Data e pritshme	shkurt 2019	shtator 2019	Janar 2020	gusht 2020	maj 2023	nëntor 2023
3AF10009-0	Sigurimi i mjediseve për municionin	1 muaj	7 muaj	4 muaj	7 muaj	33 muaj	6 muaj
	Data e pritshme	shkurt 2019	shtator 2019	Janar 2020	gusht 2020	maj 2023	nëntor 2023
3AF10010-0	Sigurimi i qendrës kundër avarive dhe zjarrit	1 muaj	7 muaj	4 muaj	7 muaj	21 muaj	6 muaj
	Data e pritshme	shkurt 2019	shtator 2019	Janar 2020	gusht 2020	maj 2022	nëntor 2022
3AF10011-0	Restaurimi i pistës	1 muaj	7 muaj	4 muaj	7 muaj	33 muaj	6 muaj
	Data e pritshme	shkurt 2019	shtator 2019	Janar 2020	gusht 2020	maj 2023	nëntor 2023

Shënim. Afatet e parashikuara u nënshtrohen ndryshimeve.

ANEKS C
SHPENZIMET E PARASHIKUARA TË MENAXHIMIT TË PROJEKTIT NSPA

Artikulli/zëri		Shpenzimet e parashikuara të menaxhimit të projektit NSPA (euro)/vit				
	2019	2020	2021	2022	2023	TOTALI
Civilët ndërkombëtarë të NATO-s	127,000 euro	254,000 euro	254,000 Euro	254,000 euro	127,000 euro	**1,016,000 euro**
Udhëtime	12,500 euro	25,000 euro	25,000 euro	25,000 euro	12,500 euro	**100,000 euro**
Trajnim	1,000 euro	1,000 euro	1,000 euro	1,000 euro	1,000 euro	**5,000 euro**
Komunikime	1,500 euro	1,500 euro	1,500 euro	1,500 euro	1,500 euro	**7,500 euro**
Printime dhe riprodhime	1,000 euro	1,000 euro	1,000 euro	1,000 euro	1,000 euro	**5,000 euro**
Shërbime (konsulentë, sigurime, mjekësore, automjete, zyrë)	30,000 euro	200,000 euro	200,000 euro	200,000 euro	50,000 euro	**680,000 euro**
Investime (skanerë IT, faks, telefona)	5,000 euro	10,000 euro	5,000 euro	5,000 euro	2,500 euro	**27,500 euro**
Shpenzime tej limitit të agjencisë/shpenzime të tërthorta	76,000 euro	152,000 euro	152,000 euro	152,000 euro	76,000 euro	**608,000 euro**
Totali për vit	**254,000 euro**	**644,500 euro**	**639,500 euro**	**639,500 euro**	**271,500 euro**	**2,449,000 euro**

Shënim. Kjo është kostoja e parashikuar e menaxhimit të projektit NSPA.

Kjo nuk përfshin shërbimet e kontraktuara si shërbimet konsulencës arkitekturore dhe inxhinierike dhe QA.

NATO E PAKLASIFIKUAR

ANEKS D I NSPA ALB TSA, VITET 2019–2022, DATË DHJETOR 2018

ANEKSI D
GARANCIA

1. Garancitë. Më poshtë janë parashikuar kushtet dhe procedurat e përgjithshme që NSPA-ja synon të zbatojë.

1.1 Kohëzgjatja e garancive

Kontraktuesi jep kushtet e mëposhtme të garancisë:

Në përgjithësi garancia bazohet në Kodin Civil të Shtetit Pritës. Garancia minimale për përshtatshmërinë e strukturave duhet të jepet sipas dekretit përkatës të shtetit pritës. Kontraktuesi garanton punët e ndërtuara dhe të vëna në dispozicion, sipas kësaj kontrate kundrejt të gjitha defekteve të projektimit, materialeve dhe/ose punëtorisë, përveç atyre të shkaktuara nga amortizimi i zakonshëm, dhe kundrejt çdo dëmi, rastësor apo dëmi tjetër që rrjedh gjatë periudhës/ave të kohës apo edhe më tej, nëse Kodi i Shtetit pritës e parashikon këtë:

Punët civile

Nënsistemet	***Garancia e kërkuar***
Qëndrueshmëria strukturore e themeleve dhe superstrukturave	*10 vjet*
Izolimi i çative nga uji	*10 vjet*
Suvatimet e ndërtesave	*3 vjet*
Izolimi termik i dyerve dhe dritareve	*3 vjet*
Sipërfaqet e pistave	*5 vjet*
Rrugët, themelet e përforcuara, trotuaret e përforcuara	*3 vjet*
Të tjera	*2 vjet*

Instalimet elektrike

Nënsistemet	***Garancia e kërkuar***
Komponentët kryesorë të fiksuar (panelet, kabllot dhe telat, ndriçimi, daljet)	*3 vjet*
Çelësat dhe panelet kryesore	*Konkurruese, por jo më pak se dy vjet*

Punimet mekanike

Nënsistemet	***Garancia e kërkuar***
Punimet hidraulike dhe kullimet	*5 vjet*
Artikujt e lëvizshëm (pompat, saraçineskat, ndarësi i vajit etj.)	*3 vjet*
Komponentët e fiksuar HVAC	*5 vjet*
Pajisjet HVAC	*Konkurruese por jo më pak se dy vjet*

Garancia e mësipërme plotëson dhe përforcon garancitë tregtare të ofruara nga Kontraktori nëpërmjet furnitorëve të artikujve të rij të tregtuar. Dëmet dhe avaritë, për shkak të keqpërdorimit që shkojnë tej amortizimit të zakonshëm dhe/ose mungesës së mirëmbajtjes sipas specifikimit në udhëzimet e operimit të punëve ose pajisjeve të dhëna sipas kësaj kontrate. Kuptohet se janë jashtë objektit të kësaj garancie.

1.2 Data e fillimit të periudhës së garancisë është:

Data e fillimit të periudhës së garancisë për çdo ndërtesë, është dita kur bordi i ndërtimit të HN ALB-së deklaron pranimin e aktit të shfrytëzimit.

2. PROCEDURAT E PERIUDHËS SË GARANCISË

2.1Komunikimi i çështjeve të garancisë

Nëse zbulohet një defekt, HN ALB-ja ose përfaqësuesi i caktuar i HN ALB-së duhet të përcaktojë fillimisht, nëse defekti rrjedh nga abuzimi i përdoruesit, operimi ose mirëmbajtja e papërshtatshme, probleme të projektimit apo të ndërtimit. Ky përcaktim fillestar mund të kërkojë asistencën e Nëpunësit Kontraktues të NSPA-së (CO) ose përfaqësuesit të caktuar (TRCO), nëse ka dyshim në lidhje me përgjegjësinë e Kontraktuesit. Nëse defekti është përgjegjësi e Kontraktuesit, për të përshpejtuar procesin, përpjekjet për të kryer korrigjimin duhet të bëhen fillimisht nga HN ALB-ja ose përfaqësuesi i caktuar i HN ALB-së, duke kontaktuar kontraktuesin nëpërmjet formularit që jepet në një datë të mëvonshme dhe duke informuar NSPA-në.

2.2Defektet kritike

Njoftimi i menjëhershëm i bëhet Kontraktuesit nga HN ALB-ja ose përfaqësuesi i caktuar i HN ALB-së për defektet e natyrës kritike, d.m.th., defekte që ndikojnë në operimin, sigurinë e jetës dhe sigurinë e fluturimit. Njoftimi do të kërkojë që kontraktuesi të japë një përgjigje të përshtatshme me kujdesin e duhur dhe sipas kushteve dhe termave të kontratës. Nëse kontraktuesi nuk fillon punën sipas garancisë, NSPA, CO dhe TRCO duhet të kontaktohen për të nxitur veprimin.

2.3 Defektet jokritike

Një listë e defekteve jokritike duhet të mbahet nga HN ALB-ja ose përfaqësuesi i autorizuar i HN ALB-së dhe paraqitet në muajin e katërt dhe gjatë inspektimeve vjetore të garancisë. Defektet që konstatohen se janë abuzim i përdoruesit ose operim ose mirëmbajtje e papërshtatshme janë

përgjegjësi e HN ALB-së. Nëse ka mosmarrëveshje në lidhje me shkakun e defektit, kjo zgjidhet nga NSPA CO.

2.4 Procedurat

2.4.1 Në parim, riparimi i defekteve duhet të kryhet sa më parë të jetë e mundur sipas grafikut të dhënë nga kontraktuesi, por jo më vonë se 30 ditë pune pas njoftimit nga përfaqësuesi i HN ALB. Riparimet sipas garancisë, të cilat nuk mund të përfundohen brenda vlefshmërisë së pretendimit të garancisë, duhet të kryhen brenda një periudhe të arsyeshme kohe pas skadimit të periudhës së garancisë.

2.4.2 Procedurat për defekte tipike janë të listuara më poshtë te zyra përgjegjëse. Në të gjitha rastet e tjera, NSPA CO duhet të kryhet në dijeni të veprimeve sipas garancisë, për të marrë drejtimin në bashkërendim me HN ALB-në për të korrigjuar defektet e identifikuara me mjetet më të shpejta të mundshme, veçanërisht në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të mundshme dhe koordinimin e përdorimit të fondeve të performancës dhe garancisë.

2.4.3 HN ALB-ja duhet të vendosë përfundimisht nëse do të vijojë me ndreqjen nëpërmjet kontraktuesit. Ky është një vendim biznesi dhe sigurie që duhet të merret, duke pasur parasysh fondet e kërkuara kundrejt mundësisë së rikuperimit, dhe nëse veprimi i rikuperimit do të ndërmerret në kohë për të përmbushur nevojat e HN ALB-së.

2.4.4 Në lidhje me mangësitë në ndërtim që mbulohen nga garancia e kontratës, përpjekjet për të kryer korrigjimin duhet të bëhen fillimisht nga HN ALB-ja ose përfaqësuesi i caktuar i HN ALB-së. Nëse përpjekjet e HN ALB-së për të zgjidhur problemin me kontakt të drejtpërdrejtë me kontraktuesin nuk japin sukses, HN ALB-ja duhet të kontaktojë NSPA CO dhe TRCO për veprime të mëtejshme.

2.4.5 Për mangësitë në projektim ose ndërtim që nuk mbulohen nga dispozitat dhe garancitë e kontratës, pas identifikimit dhe vlerësimit, HN ALB-ja do të realizojë rikuperimin duke përdorur fondet e përshtatshme të projektit.

2.4.6 Inspektimet e garancisë

Në afërsisht katër muaj dhe çdo vit pas transferimit, TRCO dhe HN ALB-ja dhe kontraktuesi do të kryejnë inspektime të përbashkëta për të identifikuar defektet dhe planifikuar veprimet rikuperuese. NSPA CO ose TRCO do të kontaktojnë HN ALB-në para këtyre inspektimeve për një listë mangësish që mbahet nga HN ALB-ja. Lista do të përdoret për të ndihmuar në identifikimin e defekteve.

2.4.7 Riparimi i artikujve brenda garancisë

Politika për riparimin e artikujve, sipas dispozitave të garancisë, është që garancia e kufizuar sipas parashikimit në 1.1, nuk shtyhet. Për qëllime ilustrimi, nëse një artikull riparohet në ditën e fundit të periudhës së kontratës, garancia skadon ditën tjetër, me gjithë riparimin/zëvendësimin e ri. Është e arsyeshme të lejohen periudha shtrimi pas riparimeve, me qëllim që të garantohet operativiteti i artikullit të riparuar para skadimit të garancisë.

3. VEPRIMET E NSPA-së PAS PERIUDHËS SË GARANCISË

FONDET E GARANCISË

NSPA-ja ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për të rikuperuar koston e defekteve nga kontraktuesi, nëse ata konsiderohen përgjegjës. As pranimi nga HN ALB-ja i punëve dhe as përfundimi i periudhës së garancisë nuk e pushon përgjegjësinë e kontraktuesit për një çështje të një natyre të fshehtë. Megjithatë, barra e provës për të konstatuar defektin për shkak të defekteve të fshehura, i bie HN ALB-së.

Sapo të dyshohet për një defekt të fshehur, HN ALB-ja duhet të kontaktojë me NSOA CO, nëse duhet të kryhet një inspektim i përbashkët. Nëse kontraktuesi përgjegjës për garancinë ose defektin e fshehur refuzon të kryejë riparimin ose nuk është më në këtë aktivitet, NSPA CO njofton garantuesin i cili ka dhënë fondin e kërkuar të performancës për kontratën e ndërtimit ose ndonjë instrument tjetër fondi garancie. NSPA CO do të ndjekë riparimet sipas garancisë me garantuesin, si dhe kontraktuesin derisa të jenë rikuperuar të gjitha defektet sipas garancisë.

NATO E PAKLASIFIKUAR

DEKRET
Nr. 11810, datë 4.11.2020

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93, të Kushtetutës

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 131/2020, "Për ratifikimin e marrëveshjes për mbështetje teknike ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Mbështetjes dhe Prokurimit të NATO-s për realizimin e projekteve të Kuçovës, të financuara nga programi i investimeve të NATO-s për sigurinë, vitet 2019–2022.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 67/2020

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË PERSONELIT ME KOHË TË PLOTË PUNE TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe të nenit 19, shkronja "m", të ligjit nr. 10019, datë 28.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit me kohë të plotë pune të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

II. Struktura e personelit me kohë të plotë pune të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

III. Organika dhe klasifikimi i pagave të personelit me kohë të plotë pune të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 5.11.2020.

Strukturë-Organigrama e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve



Punonjës gjithsej 85

Lidhja nr.1

ORGANIKA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE Lidhja 2

	POZICIONI	KATEGORIA/ KLASA	NUMRI
1	KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE	Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor" i ndryshuar	1
1.1	KABINETI		
	DREJTOR	I-a	1
	KËSHILLTAR	Barazohet në pagë zëvendësministrin	2
	ZËDHËNËSE	II b	1
	SEKRETARE	Pika 6, VKM nr. 187, datë 18.3.2017	1
2	NËNKOMISIONER	Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor", i ndryshuar	1
	Sekretare	Pika 6, VKM nr. 187, datë 18.3.2017	1
3	SEKRETAR I PËRGJITHSHËM	I-b	1
4	DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ADMINISTRIMIT TË ZGJEDHJEVE		
	DREJTOR	II-a	1
4.1	DREJTORIA E KOMISIONEVE DHE MATERIALEVE ZGJEDHORE		
	DREJTOR	II -b	1
4.1.1	Sektori i trajnimeve		
	Shef Sektori	III-a	1
	Specialist	III-b	2
4.1.2	Sektori i koordinimit dhe mbikëqyrjes		
	Shef sektori	III-a	1
	Specialist	III-b	4
4.1.3	Sektori i mjeteve dhe i materialeve zgjedhore		
	Shef sektori	III-a	1
	Specialist	III-b	2
4.2	DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TE DHËNAVE DHE SISTEMEVE IT		
	DREJTOR	II-b	1
4.2.1	Sektori i administrimit të të dhënave dhe të sistemeve		
	Shef Sektori	III-a	1
	Specialist	III-b	5
4.2.2	Sektori për votimin e emigrantëve		

	Shef sektori	III-a	1
	Specialist	III-b	2
4.3	DREJTORIA E KOMUNIKIMIT		
	DREJTOR	II-b	1
4.3.1	Sektori i programeve të edukimit të zgjedhësve		
	Shef sektori	III-a	1
	Specialist	III-b	2
4.3.2	Sektori i vëzhgimit dhe koordinimit ndërkombëtar		
	Shef sektori	III-a	1
	Specialist	III-b	2
5	DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE, EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		
	DREJTOR	II-a	1
5.1	DREJTORIA JURIDIKE DHE E DOKUMENTACIONIT ZGJEDHOR		
	DREJTOR	II-b	1
5.1.1	Sektori i Përgatitjes së Akteve		
	Shef sektori	III-a	1
	Specialist	III-b	5
5.1.2	Sektori i Verifikimit të Dokumenteve dhe Këshillimit Ligjor mbi Ankesat Administrative e Gjyqësore		
	Specialist	III-b	3
5.1.3	Sektori i dekriminalizimit		
	Shef sektori	III-a	1
	Specialist	III-b	2
5.2	DREJTORIA E KONTROLLIT FINANCIAR DHE AUDITIT TË BRENDSHËM		
	DREJTOR	II-b	1
5.2.1	Sektori i kontrollit financiar		
	Shef Sektori	III-a	1
	Specialist	III-b	2
5.2.2	Sektori i auditit të brendshëm		
	Shef sektori	III-a	1
	Specialist	III-b	2

5.3	DREJTORIA E BUXHETIT DHE FINANCËS		
	DREJTOR	II-b	1
	Specialist	III-b	3
5.4	DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE		
	DREJTOR	II-b	1
5.4.1	Sektori i administrimit dhe i arkivimit të dokumentacionit		
	Shef sektori	III-a	1
	Specialist	III-b	4
5.4.2	Sektori i burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse		
	Shef sektori	III-a	1
	Specialist	III-b	2
	Sekretare	Pika 6, VKM nr. 187, datë 18.3.2017	2
	Recepsionist	VKM nr. 717, datë 23.6.2009, i ndryshuar	1
	Shofer	-	2
	Magazinier	-	1
	Punonjës pastrimi	-	3
	Postier	-	1
	Fotokopjues	-	1
	Punonjës mirëmbajtje	-	1
	PUNONJËS GJITHSEJ		**85**

VENDIM
Nr. 851, datë 4.11.2020

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 546, DATË 11.8.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E PAGAVE DHE SHTESAVE MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË SHTETET E HUAJA, TË ATASHEVE USHTARAKË TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PERSONELIT CIVIL TË MINISTRISË SË MBROJTJES QË SHËRBEJNË NË PËRFAQËSITË USHTARAKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË NATO-s, NË ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE DHE NË SHTABET USHTARAKE NDËRKOMBËTARE, TË PUNONJËSVE SHQIPTARË PËR KOHËN QË SHËRBEJNË SI NËPUNËS NDËRLIDHËS PRANË QENDRËS SECI, TË PUNONJËSVE SHQIPTARË PËR KOHËN QË SHËRBEJNË SI OFICERË KONTAKTI, PRANË MINISTRIVE TË BRENDSHME HOMOLOGE TË SHTETEVE TË NDRYSHME TË ATASHUAR NË PËRFAQËSITË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE TË PUNONJËSVE TË SEKRETARIATIT TË MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL PËR KOHËN QË SHËRBEJNË SI PËRFAQËSUES TË KËSAJ MINISTRIE PRANË MISIONIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BRUKSEL", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të ligjit nr. 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ligjit nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", të ndryshuar, të ligjit nr. 113/2018, "Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe *Eurojust*", dhe të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 546, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat, me këtë përmbajtje:

a) Në fund të titullit të vendimit shtohen fjalët "... dhe prokurori i sistemit të prokurorisë për kohën që shërben si prokuror ndërlidhës pranë *Eurojust*, në Hagë, Holandë ...".

b) Pas pikës 1/5 shtohet pika 1/6, me këtë përmbajtje:

"1/6. Prokurori i sistemit të prokurorisë për kohën që shërben si prokuror ndërlidhës pranë *Eurojust,* në Hagë, Holandë.".

c) Pas pikës 6/1 shtohen pikat 6/2, 6/3 dhe 6/4, me këtë përmbajtje:

"6/2. Paga mujore e punonjësit të përcaktuar sipas pikës 1/6 të këtij vendimi, përbëhet nga elementet, si më poshtë vijon:

a) "Paga bazë mujore", e cila është paga mujore bruto e pozicionit që prokurori ka mbajtur në momentin e komandimit si prokuror ndërlidhës; dhe

b) "Shtesa e përfaqësimit" në masën 40%, që llogaritet mbi "pagën bazë mujore", të përcaktuar sipas shkronjës "a", të kësaj pike.

6/3. Përveç pagës mujore, të përcaktuar, sipas pikës 6/2 të këtij vendimi, ky punonjës përfiton edhe kompensimin për koston e jetesës, në masën 230 (dyqind e tridhjetë) euro.

6/4. Për punonjësin e përcaktuar, sipas pikës 1/6 të këtij vendimi, trajtimi me pagë dhe kompensimi për koston e jetesës, sipas këtij vendimi, fillon nga data e fillimit të detyrës së tij pranë *Eurojust.".*

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të fillojnë nga data e fillimit të detyrës së prokurorit ndërlidhës pranë *Eurojust* dhe, për vitin 2020, të përballohen nga fondet e miratuara për sistemin e prokurorisë, për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 852, datë 4.11.2020

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË KUKËS TË NJËSIVE TAKUESE, PJESË TË PASURISË NR. 25/9, ZONA KADASTRALE 2315, DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 167, DATË 10.3.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË KUKËS, TË QARKUT TË KUKËSIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, shkronja "c", të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të neneve 3 e 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit bashkëlidhur vendimit nr. 167, datë 10.3.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, përmasat e pronës me emërtimin "Bashkia" zëvendësohen sipas planrilevimit dhe planimetrive që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Transferimin në pronësi nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës te Bashkia Kukës të njësisë, me sipërfaqe 255 (dyqind e pesëdhjetë e pesë) m^2, në katin përdhes, pjesë të pasurisë nr. 25/9, zona kadastrale 2315, sipas formularit dhe planimetrisë që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

3. Kalimin në pronësi të Bashkisë Kukës të njësisë me sipërfaqe 558 (pesëqind e pesëdhjetë e tetë) m^2, në katin e tretë, pjesë të pasurisë nr. 25/9, zona kadastrale 2315, sipas formularit dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

4. Pronat e përcaktuara në pikat 2 dhe 3, të këtij vendimi, i shtohen listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 167, datë 10.3.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

5. Prona e përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, bashkëlidhur vendimit nr. 448, datë 16.6.2005, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme", të ndryshuar.

6. Ngarkohen Bashkia Kukës, Këshilli i Qarkut Kukës dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

PLAN RILEVIMI

BASHKIA KUKES Përgatiti: Ark. Edrion Laçi	A. IDENTIFIKIMI I PASURISË ZONA KADASTRALE: 2315 NR.I.PASURISË: 25/9 INDEKSI I HARTËS: KU; H-5 SHKALLA: 1:500 ADRESA E PASURISË: BASHKIA KUKES, SHESHI "SKENDERBEJ" LLOJI I PASURISE : TRUALL SIPERFAQJA E TRUALLIT : 968 m2 SIPERFAQJA E NDERTESES : 585 m2 B. KUFIZIMET VERI: 28/7 , 25/8 JUG: 25/51, 25/10 LINDJE: 25/10 PERENDIM: 24/37_ C. PRONARI BASHKIA KUKES D.Data: 16.07.2020

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE KRGJSH



KOORDINATAT E PIKAVE KRRGJSH

NR.	X	Y
1	534461.00	4660302.50
2	534465.83	4660307.29
3	534467.30	4660305.71
4	534481.71	4660319.15
5	534486.17	4660314.79
6	534486.82	4660315.38
7	534489.07	4660313.22
8	534487.54	4660311.72
9	534491.40	4660307.52
10	534486.85	4660303.23
11	534493.77	4660295.77
12	534494.57	4660296.46
13	534497.49	4660293.67
14	534496.42	4660292.38
15	534499.92	4660288.70
16	534501.21	4660289.67
17	534507.21	4660283.32
18	534495.86	4660272.71
19	534492.83	4660275.64
20	534488.75	4660272.14

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Institucioni përgjegjës: Bashkia Kukës

Fusha e perdorimit te Prones: Funksione administrative

Identifikoi: **Edrion Laçi, Shefi Sektorit te PKZHT** (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Supervizoi: **Andrit Shehu, Drejtor I PKZHT** (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Aprovoi: **Safet Gjici, Kryetar i Bashkisë Kukës** (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

Nr. Rend.	A			B			C			
	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	2315 KU-H-5	25/9	Truall+ndertese	Godina e bashkise Kukës Lagja nr.5 Bashkia Kukes	968 m2	585 m2	Administrate	Bashkia Kukës	Bashkia Kukës	Godina eshte 4 Kate Kati perdhe me sip 585 m2 Kati I pare me sip 569 m2
										Kati I dyte me sip 558 m2 Kati I trete me sip 558 m2

GODINA E BASHKISE KUKES

P L A N I M E T R I A E K A T I T E P E R D H E

SHKALLA 1 : 150

SIP. TOTALE---------- 585 M2

SIP.E AMBIENTEVE QE KALOJNE NE PRONESI TE BASHKISE KUKES-- 255 M2

SIP.E AMBIENTEVE NE PRONESI TE BASHKISE KUKES ----------330 M2



AMBJENTET E BASHKISE
SIP. 330 M2

AMBJENTET QE KALOJNE NE PRONESI
TE BASHKISE KUKES - SIP= 255 M2

HARTOI : ARK. EDRION LAÇI

GODINA E BASHKISE KUKES

P L A N I M E T R I A E K A T I T T E P A R E

SHKALLA 1 : 200

SIP. 569 M2



HARTOI : ARK. EDRION LAÇI

GODINA E BASHKISE KUKES

P L A N I M E T R I A E K A T I T T E D Y T E

SHKALLA 1 : 150

SIP. 558 M2



HARTOI : ARK. EDRION LAÇI



VENDIM
Nr. 853, datë 4.11.2020

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË KËSHILLIT TË QARKUT KUKËS TË NJË PJESE TË PASURISË NR. 23/70, NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 2315

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja "c", të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave te paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Këshillit të Qarkut Kukës të sipërfaqes 23.92 (njëzet e tre pikë nëntëdhjetë e dy) m^2, të katit përdhes, të sipërfaqes 262.78 (dyqind e gjashtëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e tetë) m^2, të katit të dytë dhe të sipërfaqes 105.91 (njëqind e pesë pikë nëntëdhjetë e një) m^2, të katit të tretë, pjesë të pasurisë nr. 23/70, zona kadastrale 2315, sipas formularit dhe planimetrive që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Këshillit të Qarkut Kukës i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen Këshilli i Qarkut Kukës dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Institucioni: Keshilli Qarkut Kukës

Identifikoi: Ing. Beglije Cenaj, Specialist e P.Territorit
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizoi: Ing. Omer Llukovi, P/Sektorit te Sh.Publike dhe te P.Territorit
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Fusha e përdorimit të Pronës: Administratë

Aprovoi: Abdulla Domi, Kryetar i Keshillit te Qarkut Kukës
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

	A		B				C			
Nr. Rend	Zona Kadastr. Indeksi i Hartës	Nr. Pasurisë	Emërtesa e Pronës Vendndodhja / Shtrirja Gjeografike	Komponentët përbërës te Pronës	Adresa/Vendndodhja e komponentëve përbërës	Përmasat e Pronës në m^2 ose ml	Funksioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni/Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Te dhëna të tjera (Shënime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	2315 KU-H-6	23/70-N3	Njesi	Ndërtesë Kati Perdhe	Lagjia Nr.1 Kukës	23.92	Garazh	K.Qarkut Kukes	K.Qarkut Kukes	
2	2315 KU-H-6	23/70-N5	Njesi	Ndertese Kati I Dyte	Lagjia Nr.1 Kukës	262.78	Administrate	K.Qarkut Kukes	K.Qarkut Kukes	
3	2315 KU-H-6	23/70-N6	Njesi	Ndertese Kati I Trete	Lagjia Nr.1 Kukës	105.91	Administrate	K.Qarkut Kukes	K.Qarkut Kukes	

PLANIMETRIA E KATIT PËRDHE



Sip.ndërtimi me hapësire shfrytëzimi nga zyrat e QARKU KUKËS 23.92 m^2

Matjet në terren:
Ing. Sali Shehu
Ing. Oltjon Gaxha

Punoi planimetritë:
Ing. Ardit Halilaj


PLANIMETRIA E KATIT PARË
Punoi planimetritë:
Ing. Arcit Hallaj
Matjet ne terren:
Ing. Sali Shehu
Ing. Oltjon Gaxha
Sip.ndërtimi me hapësirë shfrytëzimi nga zyrat e DV. ASHK KUKËS 262.78 m 2
REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AGJENCIA GJEOHAPËSIRE E KADASTRËS - DREJTORIA VENDORE KUKËS


PLANIMETRIA E KATIT DYTË
Sip.ndërtimi me hapësirë shfrytëzimi nga zyrat e QARKU KUKËS 262.78 m²
Matjet në terren:
Ing. Sali Shehu
Ing. Oltjon Gaxha
Punoi planimetritë:
Ing. Ardit Hallaj


PLANIMETRIA E KATIT TRETË
Punoi planimetritë:
Ing. Ardit Hallaj
Matjet në terren:
Ing. Sali Shehu
Ing. Oltjon Gaxha
Sip.ndërtimi me hapësirë shfrytëzimi nga zyrat e QARKU KUKËS 105.91 m²

VENDIM
Nr. 854, datë 4.11.2020

PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, TEK AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS, TË NJË PJESE TË PASURIVE NR. 23/69, NR. 23/70 E NR. 23/270, NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 2315, DHE PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 448, DATË 16.6.2005, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI ZYRËS QENDRORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja "c", të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e përgjegjësisë së administrimit, tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të truallit 232.06 (dyqind e tridhjetë e dy pikë zero gjashtë) m^2, pjesë e pasurisë nr. 23/69, zona kadastrale 2315, të truallit 389 (treqind e tetëdhjetë e nëntë) m^2, pjesë e pasurisë nr. 23/70, zona kadastrale 2315, dhe të truallit 93.5 (nëntëdhjetë e tre pikë pesë) m^2, pjesë e pasurisë nr. 23/270, zona kadastrale 2315, sipas hartës kadastrale që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të sipërfaqes 262.78 (dyqind e gjashtëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e tetë) m^2, në katin përdhes, dhe të sipërfaqes 262.78 (dyqind e gjashtëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e tetë) m^2, në katin e parë, të pasurisë nr. 23/70, zona kadastrale 2315, sipas formularit dhe planimetrive që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

3. Pronat e përcaktuara në pikat 1 e 2, të këtij vendimi, i shtohen listës së pronave të paluajtshme shtetërore, bashkëlidhur vendimit nr. 448, datë 16.6.2005, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme", të ndryshuar.

4. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Institucioni: **Agjencia Shtetërore e Kadastrës**

Fusha e perdorimit të Pronës: **Administratë**

Identifikoi: **Ing. Oltion Gaxha, Specialist terreni në DV ASHK Kukës** (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Supervizoi: **Ing. Lorela Beqiraj, Specialiste në DV ASHK Kukës** (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Aprovoi: **Ing. Vladimir Spahiu, Drejtor i DV ASHK Kukës** (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

	A		B				C			
Nr. Rend	Zona Kadastr. Indeksi i Hartës	Nr. Pasurisë	Emertesa e Pronës Vendndodhja / Shtrirja Gjeografike	Komponentet përbërës te Pronës	Adresa/Vendndodhja e komponentëve përbërës	Përmasat e Pronës në m^2 ose ml	Funksioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni/Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Te dhëna të tjera (Shënime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	2315 KU-H-6	23/70-N2	Njesi	Ndertese Kati Perdhe	Lagjia Nr.1 Kukës	262.78	Administratë	ASHK	DV ASHK Kukës	
2	2315 KU-H-6	23/70-N4	Njesi	Ndertese Kati i Pare	Lagjia Nr.1 Kukës	262.78	Administratë	ASHK	DV ASHK Kukës	
3	2315 KU-H-6	23/70	Truall	Truall funksional I objektit	Lagjia Nr.1 Kukës	389	Truall funksional	ASHK	DV ASHK Kukës	
4	2315 KU-H-6	23/69	Truall	Truall funksional I objektit	Lagjia Nr.1 Kukës	232.06	Truall funksional	ASHK	DV ASHK Kukës	
5	2315 KU-H-6	23/270	Truall	Truall funksional I objektit	Lagjia Nr.1 Kukës	93.5	Truall funksional	ASHK	DV ASHK Kukës	

HARTË KADASTRALE

(Fragment)

DREJTORIA VENDORE
E AGJENCISË SHTETËRORE
TË KADASTRËS
KUKËS

DREJTORI
Ing.Vladimir Spahiu

A. IDENTIFIKIMI I PASURISË:

ZONA KADASTRALE **2315** NR. I PASURISË (23/69/1+23/70/1+23/270/1) Vol. ____Fq. ____
INDEKSI I HARTËS **KU-H-6** SHKALLA **1:500**
ADRESA E PASURISË Rrethi **KUKËS,** Q. **KUKËS**
Rr./L. **1** P/G. _____ Sh.____ K._____ Ap. _____

B. KUFIZIMET
V. 23/69/2;23/70/2;23/270/2
J. 23/154;23/258
L. 23/153;23/271
P. 23/68;23/258

C. PRONARI/ËT
SHTET

D. Datë 29/05/2020 Ora: _____

Përgatiti: Ing. Gjeodet Bujar Zejnelaj

____ KUFIRI I PRONËS ME SIPËRFAQE TRUALL=714.56 m², NGA KJO: NDËRTESË=286.70 m².

GJENDJA JURIDIKE E PASURIVE MBI TË CILËN NDODHET KJO PRONË:
Pasuria nr.23/69: Vol.2, Fq. 128, Shesh, Sip. =268 m², Pronari: Shtet;
Pasuria nr.23/70: Vol. 2, Fq.129, Truall, Sip. =405 m² , Nga kjo Ndërtesë=405 m², Pronari: Shtet;
Pasuria nr.23/270: Vol.31, Fq. 176, Truall, Sip.=155,53 m², Pronari: Shtet.

PASURIVE TË MËSIPËRME DO TU MERREN KËTO SIPËRFAQE:
Pasurisë nr.23/69: do ti merret Sip. =232.06 m²;
Pasurisë nr.23/70: do ti merret Sip. =389 m²;
Pasuria nr.23/270: do ti merret Sip.= 93.50 m².

Sipërfaqja totale=**714,56 m².**

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE KRGJSH



HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME KUKES

REGJISTRUES

Vladimir Spahiu

Vula/Firma

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 2315 NR.I PASURISE 23/270 Vol. 31 Fq. 176
INDEKSI I HARTES KU – H – 6 SHKALLA 1 : 500
ADRESA E PASURISE Rrethi KUKËS Q/F KUKËS
Rr/L 1 P/G Sh K Ap

B. KUFIZIMET

V. 23 / 105
L. 23 / 271
J. 23 / 271 : 23 / 70
P. 23 / 69 : 23 / 70

C. PRONARI

SHTET
(I)

Digitally signed by Vladimir Spahiu
Date: 2020.09.10 03:05:41 +02'00'

D. Data 10.09.2020 Ora Vladimir Spahiu

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore Kukës
Date:2020/09/10 15:16:49 +02'00'
H50506044C2020091015163986014

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Kukës)

HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME KUKES

REGJISTRUES

Vladimir Spahiu

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 2315 NR.I PASURISE 23/69 Vol. 2 Fq. 128

INDEKSI I HARTES KU – H – 6 SHKALLA 1 : 500

ADRESA E PASURISE Rrethi KUKËS Q/F KUKËS

Rr/L 1 P/G Sh K Ap

B. KUFIZIMET

V. 23 / 105

L. 23 / 70

J. 23 / 258

P. 23 / 68

C. PRONARI

SHTET

(I)

D. Data 10.09.2020 Ora

Vladimir Spahiu

Digitally signed by Vladimir Spahiu
Date: 2020.09.10 03:05:42 +02'00'

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore Kukës
Date:2020/09/10 15:13:29 +02'00'
H50506044C2020091015132119014

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Kukës)



HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME KUKES **REGJISTRUES** **Vladimir Spahiu**	**A. IDENTIFIKIMI I PASURISE** ZONA KADASTRALE **2315** NR.I PASURISE **23/70** Vol. **2** Fq. **129** INDEKSI I HARTES **KU – H – 6** SHKALLA **1 : 500** ADRESA E PASURISE Rrethi **KUKËS** Q/F **KUKËS** Rr/L_____1_____P/G_____Sh____K_____Ap_____ **B. KUFIZIMET** V. **23 / 270** L. **23 / 153** J. **23 / 258 : 23 /154** P. **23 / 69** **C. PRONARI** **SHTET** **(I)** **D.** Data 10.09.2020 Ora _____ **Vladimir Spahiu** Digitally signed by Vladimir Spahiu Date: 2020.09.10 03:05:41 +02'00'

Vula/Firma
Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore Kukës
Date:2020/09/10 15:19:25 +02'00'
H50506044C2020091015191670014

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Kukës)

PLANIMETRIA E KATIT PËRDHE



Sip.ndërtimi me hapësirë shfrytëzimi nga zyrat e DV.ASHK KUKËS 262.78 m²

Matjet ne terren:
Ing. Sali Shehu
Ing. Oltjon Gaxha

Punoi planimetritë:
Ing. Ardit Halilaj

PLANIMETRIA E KATIT PARË



Sip.ndërtimi me hapësirë shfrytëzimi nga zyrat e DV. ASHK KUKËS 262.78 m ²

Matjet ne terren:
Ing. Sali Shehu
Ing. Oltjon Gaxha

Punoi planimetritë:
Ing. Ardit Halilaj

PLAN - VENDOSJE

PËRGATITI:

Emri : **Ing. Gjeodet Bujar SHLLAKU**

Nr. License **T. 1318**, Datë. 13.12.2018.

Data e përgatitjes: *28.05.2020.*

Vula/Firma :

IDENTIFIKIMI I PASURISË:

Zona Kadastrale	**2315**
Indeksi i Hartës	**KU-H-6**
Nr. Pasurisë	**23/70**
Shkalla	**1 - 500**
Zëri Kadastral	**NDËRTESË+TRUALL**
Adresa e Pasurisë	**Rrethi Kukës**
Njësia Vendore	**Bashkia Kukës**
Lagje	**Nr. 1**
Sipërfaqe ndertimi	**286,70 m²**
Ipërfaqe funksionale	**427,86 m²**
Siperfaqe totale e prones	**714,56 m²**

KUFIZIMET E PRONËS:

Veri : Pasuria nr.23/67, 23/228,
Jug : Pasuria nr. 23/207, 23/73
Lindje: Pasuria nr. 23/233, 23/231
Perëndim: Pasuria nr. 23/68;23/258



VENDIM
Nr. 855, datë 4.11.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 673, DATË 2.9.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PAJISJEN ME NUMËR TELEFONI CELULAR TË FUNKSIONARËVE PUBLIKË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 673, datë 2.9.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Fjalia e fundit, e pikës 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Nga ky kufizim përjashtohen institucionet e pavarura me një numër jo më shumë se 100 punonjës dhe Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.".

2. Në pikën 4, shifra "20 000 (njëzet mijë)" zëvendësohet me "30 000 (tridhjetë mijë)".

3. Në pikën 5, shifra "10 000 (dhjetë mijë)" zëvendësohet me "20 000 (njëzet mijë)".

4. Pas pikës 5 shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

"5/1. Ky shërbim mund t'u ofrohet edhe me dalje ndërkombëtare, por jo më shumë se 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj, për funksionin "Magjistrat dhe hetues në strukturat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në sistemin e akuzës dhe gjykatave".".

5. Lidhja nr. 2, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Lidhja nr. 3, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Lidhja nr. 4, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8. Lidhja nr. 5, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9. Në pikën 8, pas fjalëve "... këshilltar/ zëdhënës shtypi në kabinetin e titullarit ..." shtohen fjalët "... Drejtor në Shërbimin Informativ të Shtetit ...".

10. Pika 14 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"14. Për ofrimin e shërbimit për funksionarët e përcaktuar në pikat 5–12 të këtij vendimi lidhet kontratë individuale me cilindo prej operatorëve të shërbimit telefonik të lëvizshëm, që veprojnë në vend, për një numër të vetëm celular ose njësitë e qeverisjes së përgjithshme lidhin kontratë me cilindo prej operatorëve të shërbimit telefonik të lëvizshëm, që veprojnë në vend sipas legjislacionit në fuqi.

Detyrimi financiar, në rastin kur lidhet kontratë individuale, paguhet nga funksionari, i cili kompensohet nga institucioni, kundrejt dokumentit të blerjes së shërbimit të numrit telefonik celular, por jo më shumë se kufijtë përkatës mujorë.

Detyrimi financiar, në rastin kur lidhet kontratë nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, paguhet për shërbimin e ofruar nga njësia e qeverisjes së përgjithshme, sipas faturës mujore për vlerën e shpenzuar.".

11. Fjalia "Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare" ndryshohet me "Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2021.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lidhja nr. 2 – 40 000 lekë/muaj

1. Kryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor;
2. Kryetar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
3. Kryetar i Gjykatës së Lartë;
4. Prokuror i Përgjithshëm;
5. Drejtues i SPAK-ut/Byro Kombëtare Hetimi.

Lidhja nr. 3 – 30 000 lekë/muaj
1. Avokati i Popullit;
2. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve;
3. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit;
4. Zëvendëskryetar i Kuvendit / zëvendës-kryeministër;
5. Anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor;
6. Anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
7. Anëtarë të Gjykatës së Lartë/Gjykatës Kushtetuese;
8. Ministri;
9. Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit;
10. Titullar i institucioneve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve;
11. Kryetar i Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë.

Lidhja nr. 4 – 20 000 lekë/muaj
1. Sekretari i Përgjithshëm në institucionet Presidencë, Kuvend, Këshillin e Ministrave;
2. Drejtori i Kabinetit të Presidentit të Republikës, kryetarit të Kuvendit dhe Kryeministrit si dhe çdo funksionar në nivel politik ose në nivel drejtues i barazuar në pagë apo me pagë përkatëse më të madhe se ky funksion. Në këtë kategori përfituesish përfshihen edhe funksionet "këshilltar në kabinetin e titullarit" që kanë pagë të këtij niveli.
3. Komisionerë dhe gjyqtarë të institucioneve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve;
4. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave;
5. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve;
6. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Lidhja nr. 5 – 4 000 lekë/muaj
1. Sekretar i Përgjithshëm në ministri;
2. Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme, si dhe çdo funksionar në nivel drejtues i barazuar në pagë apo me pagë përkatëse më të madhe se ky funksion. Në këtë kategori përfituesish përfshihen edhe funksionet "këshilltar në kabinetin e titullarit" apo "zëdhënës shtypi në kabinetin e titullarit", që kanë pagë të këtij niveli.

VENDIM
Nr. 856, datë 4.11.2020

PËR NDIHMËN FINANCIARE TË DISA PREJ KATEGORIVE KRYESORE TË NDËRMARRJEVE, TË CILAT ZBATOJNË PROTOKOLLET E SIGURISË, NË KUADËR TË PARANDALIMIT E TË KONTROLLIT TË PANDEMISË COVID-19

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të neneve 11 e 17, të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, dhe të pikës 5, të nenit 41, të ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim synon dhënien e ndihmës financiare për ndërmarrjet e kategorizuara të vogla dhe të mesme në sektorin e prodhimit (në vijim "ndërmarrjet"), sipas nenit 4, të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, "Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme", të ndryshuar, sipas kodeve REV 2 NACE, në aneksin nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ndihma financiare shtrihet për periudhën nëntor–dhjetor 2020 dhe u jepet ndërmarrjeve për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve, për të zbatuar protokollet, në kuadër të pandemisë COVID-19, bazuar në numrin e të punësuarve.
3. Skema jep ndihmë financiare të drejtpërdrejtë për ndërmarrjet, që të mbulojë një pjesë të shpenzimeve, për të zbatuar protokollet, në kuadër të pandemisë COVID-19, bazuar në numrin e të punësuarve.
4. Skema mbështetëse llogaritet e jepet për ndërmarrjet, të punësuarit e të cilave figurojnë në listëpagesat e përditësuara të tatimpaguesit, për muajin qershor 2020, të dorëzuara përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
5. Ndërmarrja për çdo të punësuar në më tepër se një listëpagesë përfiton vetëm një herë ndihmën financiare, sipas këtij vendimi. Në rastet kur i punësuari është në më tepër se një

listëpagesë dhe kontributet paguhen nga të dyja ndërmarrjet, ndihmën financiare e merr ndërmarrja, e cila aplikon e para. Ndërmarrja që nuk aplikon e para, nuk e përfiton ndihmën financiare vetëm për të punësuarin që është në më tepër se në një listëpagesë. Nuk konsiderohen të punësuar individët e deklaruar me 0 (zero) lekë në listëpagesë.

6. Ndërmarrjeve u jepet si ndihmë financiare një shumë fikse, në masën 4 000 (katër mijë) lekë për çdo punonjës, e llogaritur për dymujorin nëntor–dhjetor 2020, respektivisht 2 000 (dy mijë) lekë për çdo muaj.

7. Nuk përfitojnë nga ndihma financiare ndërmarrjet, të cilat nuk rezultojnë aktive në datën e hyrjes në fuqi të vendimit e që nuk kanë dorëzuar deklaratë vjetore për vitin 2019 (tatim i fitimit ose tatim i thjeshtuar mbi fitimin).

8. Aplikimi për përfitimin e ndihmës financiare kryhet nga ana e ndërmarrjeve në sistemim e-*filling*, duke deklaruar:

a) NIPT-in e përfituesit;

b) numrin total të punonjësve për të cilët përfiton subjekti;

c) bankën, ku përfituesi ka llogarinë rrjedhëse bankare;

ç) IBAN-in e llogarisë bankare.

9. Me qëllim shmangien e abuzimit, strukturat e administratës tatimore, duke përdorur analizën e riskut, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e aplikimit, mund të kryejnë edhe verifikime të ndërmarrjeve përfituese, nëse përmbushen kriteret. Lista e ndërmarrjeve përfituese publikohet në *website*-in e administratës tatimore.

10. Në zbatim të legjislacionit ekzistues, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve i paraqet Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit (strukturës përgjegjëse për thesarin në degë) dokumentacionin përkatës për kryerjen e pagesave të detajuara, sipas bankave të nivelit të dytë, të cilat i informon për listën/listat e ndërmarrjeve përfituese të skemës mbështetëse, me të dhënat e mëposhtme:

a) NIPT-in e përfituesit;

b) numrin total të punonjësve për të cilët përfiton subjekti;

c) bankën, ku përfituesi ka llogarinë rrjedhëse bankare;

ç) IBAN-in e llogarisë bankare.

11. Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, në zbatim të procedurave ekzistuese, menjëherë, me paraqitjen e urdhërshpenzimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, kryen pagesat në total për çdo bankë të nivelit të dytë dhe kjo e fundit, bazuar në listën përmbledhëse të mësipërme të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, kryen transfertat në llogaritë bankare të ndërmarrjeve përfituese sipas këtij vendimi.

12. Ndihma financiare për ndërmarrjet përfituese mbulon periudhën nëntor–dhjetor 2020 dhe përfitohet vetëm një herë si shumë e vetme.

13. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, deri në masën 187 092 000 (njëqind e tetëdhjetë e shtatë milionë e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë, përballohen nga zëri "Nxitja e punësimit", në programin 10550, "Tregu i punës", në buxhetin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, miratuar për vitin 2020.

14. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

ANEKS NR. 1
KODET REV 2 NACE

C2452	Derdhja (fonderia) e çelikut
C2451	Derdhja (fonderia) e gizës
C2453	Derdhja (fonderia) e metaleve të lehta
C2454	Derdhja (fonderia) e metaleve të tjera joferrike
C2312	Dhënia e formës dhe transformimi i qelqit të sheshtë
C1101	Distilimi, rektifikimi dhe kombinimi i pijeve
C1320	Endja e tekstileve
C2311	Fabrikimi i qelqit të sheshtë
C2550	Farkëtimi, kovaçana, stampimi dhe petëzimi, pluhuri metalurgjik
C1431	Konfeksionimi i trikotazheve me thyesa
C1411	Konfeksionimi i veshjeve prej lëkure
C1414	Konfeksionimi i veshjeve të brendshme
C1412	Konfeksionimi i veshjeve të punës
C1419	Konfeksionimi i veshjeve të tjera dhe aksesorë
C1413	Konfeksionimi i veshjeve të tjera të jashtme
C1439	Konfeksionimin e veshjeve të tjera me thyesa
C1814	Lidhja dhe shërbime të lidhura me të
C3011	Ndërtimi i anijeve dhe i strukturave lundruese
C3012	Ndërtimi i barkave të argëtimit dhe sportive
C1310	Përgatitja e fibrave tekstile dhe filatura
C1086	Përgatitja e ushqimeve të homogjenizuara dhe ushqimeve dietetike
C1031	Përpunimi dhe konservimi i patates
C1020	Përpunimi dhe konservimi i peshkut, krustaceve dhe molusqeve
C2030	Përpunimi i bojërave, vernikëve dhe shtresave të ngjashme, bojë shkrimi dhe mastiç
C1083	Përpunimi i çajit dhe i kafesë
C2051	Përpunimi i eksplozivëve
C2060	Përpunimi i fibrave sintetike dhe artificiale
C2017	Përpunimi i kauçukut sintetik në formë primare
C1032	Përpunimi i lëngut të frutave dhe i perimeve
C2016	Përpunimi i materialeve plastike në formë primare
C2446	Përpunimi i metaleve nukleare
C2052	Përpunimi i ngjitësve
C2042	Përpunimi i parfumeve dhe i solucioneve të tualetit
C2020	Përpunimi i pesticideve dhe i produkteve të tjera agrokimike
C2120	Përpunimi i preparateve farmaceutike
C2110	Përpunimi i produkteve farmaceutike bazë
C1061	Përpunimi i produkteve të drithërave
C1910	Përpunimi i produkteve të furrës së koksit
C1051	Përpunimi i produkteve të qumështit
C1920	Përpunimi i produkteve të rafinerisë së naftës
C2014	Përpunimi i produkteve të tjera kimike me bazë organike
C2059	Përpunimi i produkteve të tjera kimike p.k.t.
C2041	Përpunimi i sapunëve dhe i detergjenteve, solucioneve të pastrimit dhe shkëlqimit
C1091	Përpunimi i ushqimeve të përgatitura për kafshët e fermës
C1092	Përpunimi i ushqimeve të përgatitura për kafshët shtëpiake
C1041	Përpunimi i vajrave dhe yndyrave
C2053	Përpunimi i vajrave esenciale
C2432	Petëzimi në të ftohtë i rripave
C3211	Prerja e monedhave
C1039	Procese të tjera përpunimi dhe konservimi të frutave dhe i perimeve
C1330	Procese përfundimtare të përpunimit të tekstileve
C1011	Prodhimi dhe përpunimi i mishit
C1012	Prodhimi dhe përpunimi i mishit të shpendëve
C2319	Prodhimi dhe transformimi i qelqeve të tjera, duke përfshirë qelqin teknik

C1052	Prodhimi i akullores
C2352	Prodhimi i allçisë dhe gëlqeres
C2442	Prodhimi i aluminit
C2592	Prodhimi i ambalazheve prej metali të lehtë
C2751	Prodhimi i aparateve shtëpiakë elektrike
C2712	Prodhimi i aparaturave të shpërndarjes dhe të kontrollit të energjisë elektrike
C2540	Prodhimi i armëve dhe i municioneve
C1722	Prodhimi i artikujve prej letre me përdorim familjar dhe sanitar, letrës së tualetit
C2341	Prodhimi i artikujve prej qeramike për përdorim shtëpiak dhe zbukurues
C3230	Prodhimi i artikujve të sportit
C2369	Prodhimi i artikujve të tjerë prej betoni, allçie dhe çimento
C1729	Prodhimi i artikujve të tjerë prej letre dhe kartoni të p.k.t.
C1392	Prodhimi i artikujve tekstilë të konfeksionuar, përveç veshjeve
C2444	Prodhimi i bakrit
C2720	Prodhimi i baterive dhe akumulatorëve
C2611	Prodhimi i bazamenteve elektronike
C2363	Prodhimi i betonit të përzier të gatshëm për përdorim
C3092	Prodhimi i biçikletave dhe i karrocave të invalidëve
C1105	Prodhimi i birrës
C1072	Prodhimi i biskotave dhe i galetave; prodhimi i pastave dhe kekëve të konservuar
C1711	Prodhimi i brumit të letrës
C1071	Prodhimi i bukës; prodhimi pastave të freskëta dhe kekëve
C2351	Prodhimi i çimentos
C2529	Prodhimi i cisternave të tjera, rezervuarëve dhe mbajtësve prej metali
C2594	Prodhimi i dadove dhe i bulonave
C2512	Prodhimi i dyerve dhe i dritareve metalike
C3103	Prodhimi i dyshekëve
D3511	Prodhimi i energjisë elektrike
C1084	Prodhimi i erëzave dhe salcave
C2314	Prodhimi i fibrave të qelqit
C3291	Prodhimi i fshesave dhe i furçave
C2821	Prodhimi i furrave, furrnaltave dhe aparaturave për djegie
C2011	Prodhimi i gazit industrial
C2530	Prodhimi i gjeneratorëve të avullit, përveç bolierëve me ujë të ngrohtë për ngrohje qendrore
C2211	Prodhimi i gomave dhe i kamerdareve, riveshja dhe rikonstruktimi i gomave dhe kamerdareve
C2651	Prodhimi i instrumenteve dhe i aparateve për matje, verifikim, kontrolle
C3250	Prodhimi i instrumenteve dhe i pajisjeve mjekësore dhe dentare
C2670	Prodhimi i instrumenteve dhe i pajisjeve optike
C3220	Prodhimi i instrumenteve muzikore
C2841	Prodhimi i instrumenteve për punimin e metaleve
C2849	Prodhimi i instrumenteve të tjera p.k.t.
C2343	Prodhimi i izolatorëve qeramikë dhe i pajisjeve izoluese
C1082	Prodhimi i kakaos, çokollatës dhe i ëmbëlsirave
C1623	Prodhimi i karpentierëve të ndërtuesve dhe të zdrukthëtarive
C2920	Prodhimi i karrocerive për mjetet e transportit: prodhimi i rimorkiove dhe gjysmërimorkiove
C1520	Prodhimi i këpucëve
C2013	Prodhimi i kimikateve të tjera me bazë inorganike
C1621	Prodhimi i kompensatës, rimesos dhe paneleve të veçanta
C2620	Prodhimi i kompjuterave dhe i pjesëve periferike
C1624	Prodhimi i kontejnerëve prej druri
C2591	Prodhimi i kovave me çikrik prej çeliku dhe mbajtës të tjerë te ngjashëm
C2815	Prodhimi i kushinetave, ingranazheve, grupeve të ingranazheve dhe elementet e drejtimit
C2572	Prodhimi i kyçeve dhe i menteshave
C1712	Prodhimi i letrës dhe i kartonit
C1721	Prodhimi i letrës dhe i kartonit të zhubrosur dhe ambalazhit të letrës dhe kartonit
C1724	Prodhimi i letrës së murit
C1723	Prodhimi i letrës së zakonshme të palëvizshme

C1394	Prodhimi i litarëve, spangove dhe rrjetave
C2364	Prodhimi i llaçit
C3240	Prodhimi i lojërave dhe i lodrave
C3020	Prodhimi i lokomotivave dhe mjetet mbështetëse të transportit hekurudhor
C1073	Prodhimi i makaronave
C2830	Prodhimi i makinerive bujqësore dhe pyjore
C2823	Prodhimi i makinerive dhe i pajisjeve të zyrave, përveç kompjuterave dhe pajisjeve periferike
C2892	Prodhimi i makinerive për industrinë nxjerrëse dhe ndërtim
C2891	Prodhimi i makinerive për metalurgjinë
C2893	Prodhimi i makinerive për përpunimin e ushqimeve, pijeve dhe duhanit
C2895	Prodhimi i makinerive për prodhimin e letrës dhe të kartonit
C2894	Prodhimi i makinerive për prodhimin e tekstileve, veshjeve dhe lëkurëve
C2896	Prodhimi i makinerive të plastikës dhe i kauçukut
C2899	Prodhimi i makinerive të tjera me përdorim të përgjithshëm p.k.t.
C2829	Prodhimi i makinerive të tjera me përdorim të përgjithshëm të p.k.t.
C2223	Prodhimi i mallrave plastike për ndërtim
C2222	Prodhimi i mallrave të paketimit prej plastike
C1106	Prodhimi i maltës
C1042	Prodhimi i margarinës dhe i yndyrave të tjera të ngjashme
C2441	Prodhimi i metaleve të çmuara
C2445	Prodhimi i metaleve të tjera joferrike
C2680	Prodhimi i mjeteve të komunikimit optike dhe magnetike
C2910	Prodhimi i mjeteve të transportit
C3102	Prodhimi i mobilieve të kuzhinës
C3109	Prodhimi i mobilieve të tjera
C3101	Prodhimi i mobilieve të zyrave dhe të dyqaneve
C2811	Prodhimi i motorëve dhe i turbinave, përveç motorëve të avionëve, automjeteve dhe motoçikleta
C2711	Prodhimi i motorëve elektrikë, gjeneratorëve dhe transformatorëve
C1103	Prodhimi i mushtit dhe i verërave të tjera me bazë frutash
C2012	Prodhimi i ngjyruesve dhe i pigmenteve
C1062	Prodhimi i niseshtesë dhe i produkteve të niseshtesë
C2740	Prodhimi i pajisjeve elektrike të ndriçimit
C2825	Prodhimi i pajisjeve ftohëse dhe ventiluese joshtëpiake
C2342	Prodhimi i pajisjeve sanitare prej qeramike
C2752	Prodhimi i pajisjeve shtëpiake joelektrike
C2822	Prodhimi i pajisjeve të ngritjes dhe të zhvendosjes
C2790	Prodhimi i pajisjeve të tjera elektrike
C2660	Prodhimi i pajisjeve rrezatuese, elektromjekësore dhe elektroterapiste
C1622	Prodhimi i parketeve për dysheme të montuar
C1395	Prodhimi i pëlhurave të paendura dhe artikujve të paendur, përveç veshjeve
C1104	Prodhimi i pijeve të tjera të fermentuara të padistiluara
C2932	Prodhimi i pjesëve dhe i aksesorëve të tjerë për mjetet e transportit dhe motorët e tyre
C2931	Prodhimi i pjesëve elektrike dhe elektronike për mjetet e transportit dhe motorët e tyre
C2015	Prodhimi i plehrave kimike dhe i komponimeve të azotit
C2443	Prodhimi i plumbit, zinkut dhe kallajit
C2813	Prodhimi i pompave dhe i kompresorëve të tjerë
C2391	Prodhimi i produkteve abrazive
C2640	Prodhimi i produkteve, elektronikave për konsumatorët
C2365	Prodhimi i produkteve me fibrave të çimentuara
C2399	Prodhimi i produkteve minerale jometalike të p.k.t.
C2362	Prodhimi i produkteve prej allçie për qëllime ndërtimi
C2361	Prodhimi i produkteve prej betoni për qëllime ndërtimi
C2593	Prodhimi i produkteve prej teli, zinxhiri dhe sustë
C2320	Prodhimi i produkteve refraktare
C1200	Prodhimi i produkteve të duhanit
C1013	Prodhimi i produkteve të mishit dhe të mishit të shpendëve
C2599	Prodhimi i produkteve të tjera metalike p.k.t.

C2229	Prodhimi i produkteve të tjera plastike
C1629	Prodhimi i produkteve të tjera prej druri; prodhimin e artikujve prej xunkthi, shporte dhe
C2349	Prodhimi i produkteve të tjera prej qeramike
C2344	Prodhimi i produkteve të tjera qeramike teknike
C1089	Prodhimi i produkteve të tjera ushqimore p.k.t.
C2219	Prodhimi i produkteve të tjerë prej kauçuku
C2521	Prodhimi i radiatorëve dhe bolierëve për ngrohje qendrore
C1081	Prodhimi i sheqerit
C3213	Prodhimi i stolive imitacion dhe artikuj të ngjashëm me to
C3212	Prodhimi i stolive të çmuara dhe artikuj të lidhur me to
C2511	Prodhimi i strukturave metalike dhe pjesët e strukturave
C2814	Prodhimi i tapave dhe valvulave
C1393	Prodhimi i tapeteve dhe i qilimave
C1399	Prodhimi i tekstileve të tjera p.k.t.
C1396	Prodhimi i tekstileve të tjera teknike dhe industriale
C1391	Prodhimi i tekstileve të tjera, pëlhurave të endura dhe thurura
C2732	Prodhimi i telave dhe i kabllove të tjerë elektrike dhe elektronike
C2571	Prodhimi i thikave
C2420	Prodhimi i tubave, tubacioneve dhe profilet e lugëta dhe pjesë të tjera prej çeliku
C2331	Prodhimi i tullave dhe i tjegullave prej qeramike
C2332	Prodhimi i tullave, tjegullave dhe produktet e ndërtimit, në argjilë të pjekur
C1512	Prodhimi i valixheve, çantave të dorës dhe të ngjashme, pajimeve të kuajve dhe të tjera
C2573	Prodhimi i veglave
C2824	Prodhimi i veglave portative me motor të inkorporuar
C1102	Prodhimi i verës nga rrushi
C2221	Prodhimi pllakave, fletëve, tubave dhe profileve prej plastike
C2630	Prodhimin e pajisjeve të komunikimit
C1107	Prodhimin e pijeve të tavolinës; prodhimi i ujit mineral dhe ujërave të tjera në shishe
C1085	Prodhimin e ushqimeve të përgatitura
C2433	Profilizimi në të ftohtë me anë të përkuljes
C1610	Sharrimi dhe zdrukthimi i drurit
C1813	Shërbime të parashtypshkrimit dhe parakomunikimit
C1811	Shtypshkrimi i gazetave
C2410	Siderurgjia, prodhimi i hekurit dhe i çelikut dhe ferroalizheve
C1511	Tanini dhe regjja e lëkurës dhe ngjyrosja e gëzofit
C2431	Tërheqja në të ftohtë e shufrave
C2370	Thyerja e gurit, dhënia e formës dhe finicioni
C2434	Trafilimi në të ftohtë i telave

VENDIM
Nr. 858, datë 4.11.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 349, DATË 12.6.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E MASAVE MBËSHTETËSE PËR NXITJEN E PËRDORIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA BURIMET E RINOVUESHME TË DIELLIT DHE ERËS, SI DHE TË PROCEDURAVE PËR PËRZGJEDHJEN E PROJEKTEVE PËR PËRFITIMIN E TYRE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 2, të nenit 8, të ligjit nr. 7/2017, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 349, datë 12.6.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun I bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja "k", e pikës 3, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"k) "Tarifa tavan" është tarifa tavan për procedurën konkurruese që përcaktohet nga ministri, duke u bazuar në tarifën e miratuar nga ERE për të njëjtën teknologji, llojin dhe kapacitetin e impiantit, koston e investimit të teknologjisë së ngjashme, si dhe tarifave të rezultuara në ankande për kapacitete të ngjashme në Shqipëri dhe vende të tjera.".

b) Pas shkronjës "l", të pikës 3, shtohen shkronjat "ll", "m", "n" dhe "nj", me këtë përmbajtje:

"ll) "Kontrata për zhvillimin e projektit" është kontrata për zhvillimin e projektit, e lidhur ndërmjet ofertuesit të përzgjedhur dhe autoritetit kontraktor.

m) "Marrëveshja përfundimtare", marrëveshja e nënshkruar nga autoriteti kontraktor, ofertuesi i përzgjedhur dhe shoqëria e projektit, që konfirmon përmbushjen e gjitha kushteve të përcaktuara në kontratën për zhvillimin e projektit dhe që e bën efektive.

n) "Procedura konkurruese me vendndodhje të përcaktuar" është procedura konkurruese e organizuar sipas rregullave të parashikuara në krerët II dhe III, të këtij vendimi, që mundëson dhënien e masave mbështetëse për impiante diellore dhe/ose nga era (eolike), me vendndodhje dhe kapacitet të instaluar, të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

nj) "Procedura konkurruese me vendndodhje të papërcaktuar" është procedura konkurruese e organizuar sipas rregullave të parashikuara në kreun III/1, të këtij vendimi, që mundëson dhënien e masave mbështetëse për impiante diellore me kapacitet të instaluar nga 5 mw deri në 10 mw dhe/ose pa kufizim kapaciteti për impiante nga era (eolike), me vendndodhje të propozuar nga ofertuesi.".

c) Shkronja "b", e pikës 5, ndryshohet si më poshtë vijon:

"b) Në rastin e procedurës konkurruese me vendndodhje të përcaktuar, kalimin në administrim të autoritetit kontraktor të pasurive të paluajtshme për realizimin dhe shfrytëzimin e projektit dhe vënien e tyre në dispozicion të shoqërisë së projektit për të gjithë kohëzgjatjen e tij, pa pagesë.".

2. Pas kreut III shtohet kreu III/I, me këtë përmbajtje:

"KREU III/1
ZHVILLIMI I PROCESIT KONKURRUES PËR PËRZGJEDHJEN E PROJEKTEVE ME PROCEDURË KONKURRUESE ME VENDNDODHJE TË PAPËRCAKTUAR

1. Ministri autorizon fillimin e procesit konkurrues për përzgjedhjen e projekteve me procedurë konkurruese me vendndodhje të papërcaktuar, duke përcaktuar të dhënat, si më poshtë vijon:

a) kapacitetin total, në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme, që mund të ofrohet në këtë procedurë të posaçme konkurruese;

b) kapacitetin e instaluar që mund të ketë çdo projekt që do të përfitojë masat mbështetëse, të cilat, për projektet fotovoltaike nuk mund të jenë më të vogla se 5 mw dhe më të mëdha se 10 mw;

c) llojin e teknologjisë së projekteve;

ç) operatorin përgjegjës të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për blerjen e energjisë;

d) dokumentet e nevojshme për zhvillimin e procesit konkurrues;

dh) kriteret e vlerësimit të ofertave;

e) kërkesat për caktimin e vendndodhjes së projektit.

3. Ministri mund të përcaktojë të organizojë procedurën konkurruese me një fazë ose me dy faza, në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

a) në procesin me një fazë, komisioni i posaçëm harton dhe publikon të gjitha dokumentet e procedurës konkurruese në një fazë;

b) në procesin me dy faza, komisioni përcakton listën e dokumenteve për fazën e kërkesave kualifikuese, që përfshijnë kërkesat teknike dhe financiare për parakualifikimin e ofertuesve. Në fazën e dytë komisioni përcakton kërkesat për fazën e propozimit, gjatë së cilës ofertuesit e parakualifikuar në fazën e parë do të ftohen për të paraqitur propozimin e detajuar teknik dhe financiar, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga komisioni.

3. Ministri ngre komisionin e posaçëm, i cili ka këto kompetenca:

a) harton dokumentet e procesit konkurrues, që specifikojnë mënyrën e zhvillimit të procesit konkurrues për përfitimin e masave mbështetëse;

b) harton kritere të veçanta të aplikimit, parakualifikimit dhe të kualifikimit, bazuar në përcaktimet e pikës 6, të kreut II;

c) harton metodologjinë e vlerësimit të ofertave, e cila është pjesë e dokumenteve të procesit konkurrues;

ç) vlerëson ofertat e ofertuesve bazuar në kriteret e parakualifikimit, kualifikimit dhe vlerësimit të ofertës;

d) harton raportin përfundimtar të vlerësimit dhe e paraqet për miratim pranë ministrit;

dh) çdo funksion tjetër bazuar në parashikimet e këtij vendimi.

4. Dokumentet e procesit të posaçëm konkurrues, ndër të tjera, përmbajnë, si më poshtë vijon:

a) ftesën për ofertë, e cila bëhet publike dhe publikohet së paku në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, si dhe në faqen e internetit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;

b) udhëzuesin për pjesëmarrës në proces;

c) sigurimin e ofertës, i cili lëshohet nga një institucion bankar apo financiar i besueshëm, në vlerën dhe formatin e parashikuar në dokumentet e procesit konkurrues;

ç) afatin e vlefshmërisë së ofertës;

d) pagesën e tarifës së pjesëmarrjes në proces;

dh) kriteret bazë të aplikimit, parakualifikimit dhe të kualifikimit;

e) kriteret e vlerësimit të ofertave;

ë) afatin e paraqitjes së ofertave, i cili në çdo rast nuk do të jetë më pak se 30 (tridhjetë) ditë;

f) çdo dokument tjetër që do të vlerësohet nga komisioni i posaçëm në përmbushje të kritereve të kualifikimit;

g) detyrimin që për një procedurë konkurruese, i njëjti subjekt nuk mund të sjellë më shumë se një ofertë.

5. Dokumentet e procesit konkurrues duhet të përfshijnë edhe që:

a) tarifa e ofertuar nga subjektet duhet të jetë në euro/mwh dhe të jetë e nivelizuar dhe e pandryshuar për një periudhë deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet;

b) tarifa e ofertuar nga subjektet nuk duhet të jetë më e lartë se tarifa tavan e përcaktuar nga ministri.

6. Për të siguruar që ofertuesit kanë kapacitetin e nevojshëm për realizimin e projektit, komisioni i posaçëm do të bazohet në kriteret bazë të aplikimit dhe të kualifikimit, në të cilat, ndër të tjera, përfshihen:

a) Kriteret ligjore:

i. në rast të bashkimit të shoqërive, ofertat e dorëzuara duhet të shoqërohen me një marrëveshje të përbashkët të ofertimit ndërmjet anëtarëve të bashkimit;

ii. vërtetime për shlyerjen e detyrimeve tatimore, pagesën e sigurimeve shoqërore dhe që shoqëria nuk është në proces falimentimi dhe/ose likuidimi;

iii. shoqëria apo bashkimi i shoqërive, si dhe drejtuesit e shoqërisë ofertuese ose e ndonjë prej shoqërive pjesëmarrëse në bashkimin e shoqërive ofertuese nuk duhet të jenë në ndjekje penale ose të jenë dënuar me një vendim të formës së prerë.

b) Kriteret financiare:

i. çdo dokumentacion i nevojshëm që vërteton gjendjen financiare të kompanisë dhe provon aftësinë e saj financiare për të realizuar projektin, sipas dokumenteve të procesit konkurrues;

ii. pasqyrat financiare, të audituara nga audituesit e licencuar, të tri viteve të fundit të veprimtarisë dhe të depozituara në organet tatimore ose, kur

shoqëria ka më pak se tre vjet që është krijuar, për periudhën e ekzistencës së saj, si dhe çdo dokumentacion tjetër financiar që provon aftësitë financiare për të realizuar projektin e propozuar, shoqëruar prej vërtetimit të licencës së audituesit.

c) Kriteret teknike:

i. shoqëria ofertuese ose bashkimi i shoqërive ofertuese duhet të provojnë vetë ose me anë të një marrëdhënieje bashkëpunimi përvojë në të shkuarën për realizimin dhe/ose shfrytëzimin e centraleve të prodhimit të energjisë elektrike prej burimeve të rinovueshme, në përputhje me dokumentet e procesit konkurrues;

ii. në varësi të teknologjisë së përzgjedhur, modulet e paneleve diellore apo të turbinave eolike, inverterat dhe komponentët e tjerë elektrikë dhe elektromekanikë, si dhe lidhjet elektrike dhe ndërfaqësimet *software* dhe *hardware* të jenë në përputhje me kërkesat e rrjetit, si dhe të sigurojnë ofrimin e të dhënave reale metrike diellore dhe/ose eolike, lidhur me prodhimin e pritshëm vjetor të energjisë;

iii. aparaturat duhet të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe kriteret e veçanta të përcaktuara nga komisioni i posaçëm.

ç) Kritere të tjera të vlerësimit të ofertës:

i. ofertuesit duhet të ofrojnë një tarifë të nivelizuar 15-vjeçare në euro/mwh, e cila do të jetë pjesë e kritereve të vlerësimit;

ii. ofertuesit duhet që në momentin e aplikimit të kenë paraqitur dokumentacionin ligjor, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, që provon marrëdhënien afatgjatë mbi tokën/pasurinë që do të përdoret për ndërtimin dhe operimin e burimit gjenerues;

iii. ofertuesi duhet të paraqesë propozimin për lidhjen me rrjetin, duke deklaruar se do të mbulojë me fondet e saj çdo kosto për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme për lidhjen e rrjetit deri në pikën e autorizuar nga operatori i rrjetit.

d) Kritere për përcaktimin e vendndodhjes:

Vendndodhja e propozuar duhet të jetë në tokë të pafrytshme ose toka që janë jo të kategorizuara si të frytshme.

7. Të drejtën për të aplikuar e ka çdo shoqëri ose bashkim shoqërish ofertuese që paguan tarifën e pjesëmarrjes në procesin konkurrues, sipas kushteve të specifikuara në dokumentet e procesit konkurrues.

8. Ofertat e ofertuesve do të vlerësohen sipas kritereve të kualifikimit të ofertës të përcaktuara në pikën 5, të këtij kreu, bazuar në një metodologji të vlerësimit të ofertave, të përbërë me pikë të ndara sipas secilit kriter, që është pjesë e dokumenteve të procesit konkurrues.

9. Metodologjia e vlerësimit të ofertave duhet të parashikojë që çmimi i ofruar nga subjektet për blerjen e energjisë të zërë së paku 50% të pikëve.

10. Për secilin prej kritereve të vlerësimit, ofertuesit duhet të sigurojnë dokumentet e nevojshme, sipas përcaktimeve në dokumentet e procesit konkurrues.

11. Kur kapaciteti i përbashkët i ofertave që përmbushin kriteret e kualifikimit, sipas këtij vendimi, është më i ulët se sa kapaciteti i ofruar nga ministria, komisioni i posaçëm shpall të gjithë ofertuesit që përmbushin kriteret e kualifikimit si ofertues të përzgjedhur.

12. Kur kapaciteti i përbashkët i ofertave që përmbushin kriteret e kualifikimit është më i lartë se sa kapaciteti i ofruar nga ministria, komisioni i posaçëm bën përllogaritjen e pikëve për ofertuesit dhe renditjen e tyre sipas rezultatit më të lartë, duke shpallur edhe ofertuesit e përzgjedhur.

13. Në përfundim të vlerësimit të ofertave, komisioni i posaçëm paraqet për miratim pranë ministrit raportin përfundimtar të vlerësimit.

14. Ministri autorizon negocimin dhe nënshkrimin e kontratës për zhvillimin e projektit me ofertuesit e përzgjedhur, që përmban të gjitha elementet për zbatimin e suksesshëm të projektit.

15. Ofertuesi i përzgjedhur duhet të formojë një shoqëri për projektin për të hyrë në marrëveshje përfundimtare, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

16. Para nënshkrimit të marrëveshjes përfundimtare, ofertuesi i përzgjedhur/shoqëria e projektit duhet të paraqesë garancinë e kontratës, sipas përcaktimeve të dokumenteve të procesit konkurrues.

17. Ofertuesi i përzgjedhur duhet të garantojë respektimin e rregullave të tregut, si dhe të kërkesave teknike të rrjetit dhe balancimit të ngarkesës në Shqipëri.

II. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 859, datë 4.11.2020

PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE EOLIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE NË ZONËN E SEMANIT, FSHATI GRYKË, NJËSIA ADMINISTRATIVE TOPOJË, BASHKIA FIER, QARKU FIER, NGA SHOQËRIA *"ALBANIAN GENERAL ELETRICITY"* SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 7/2017, datë 2.2.2017, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse në zonën e Semanit, fshati Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria *"Albanian General Eletricity"* sh.a., me elementet, si më poshtë vijon:

a) emri i aplikuesit: *"Albanian General Eletricity"* sh.a.;

b) numri i identifikimit personal të zyrës së taksave NIPT/NUIS: L41706021V;

c) tipi i centralit: Eolik;

ç) kapaciteti i instaluar: 3 mw;

d) numri i njësive gjeneruese të burimit gjenerues të energjisë dhe kapaciteti i tyre në mw: 1 (një) turbinë me kapacitet 3 mw;

dh) afati i pritshëm i vënies në punë: Koha për ndërtimin dhe vënien në operim të parkut eolik do të jetë brenda 24 (njëzet e katër) muajve nga marrja e lejes së ndërtimit;

e) vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: zona e Semanit, fshati Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier;

ë) afati i miratimit të ndërtimit: 48 (dyzet e tetë) muaj nga hyrja në fuqi e këtij miratimi;

f) koordinatat e tokës, sipas aneksit 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi;

g) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe institucione të tjera të autorizuara prej saj kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore (tremujore), gjatë realizimit e vënies në punë, me synim që të verifikojë se ecuria e punimeve, cilësia dhe konformiteti të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit e të dokumentacionit të projektit;

gj) shoqëria *"Albanian General Eletricity"* sh.a., ka detyrimin që:

i. të paraqesë periodikisht, çdo 3 (tre) muaj, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit eolik;

ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat e autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. të ketë detyrimin e dorëzimit të sigurimit të kontratës, në masën jo më pak se 5 (pesë) % të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës ndërmjet shoqërisë *"Albanian General Eletricity"* sh.a. dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat e detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera, që lidhen me zbatimin e saj;

iv. t'i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë, sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, *"Albanian General Eletricity"* sh.a., duhet t'i derdhë tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t'i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

ANEKS 1
KOORDINATAT E TOKËS

Shoqëria *"Albanian General Eletricity"* sh.a. është pajisur me një kontratë qiraje për një tokë pa frut (ranishte), me sipërfaqe të përgjithshme 181 000 (njëqind e tetëdhjetë e një mijë) m^2, e ndodhur në Fier, e regjistruar në ZVRPP Fier, me volum 10, faqja 20, me numër pasurie 554/1, ndodhur në zonën kadastrale 3358, me kufizimet e pasurisë, veri: pasuria 554/2, lindje: pasuria 555, jug: pasuria 561 dhe perëndim: pasuria 553; kontrata nr. 587 rep., nr. 167 kol., datë 28.3.2018, "Kontratë qiraje toke pasuri shtetërore", ndërmjet Bashkisë Fier e bashkimit të përkohshëm të shoqërive *"Albanian General Electricity"* sh.a. dhe *"Seman Energy"* sh.p.k.

X	Y
4364262.143	4517992.893
4364092.824	4518075.977
4364190.954	4517848.985
4364021.985	4517932.099

VENDIM
Nr. 860, datë 4.11.2020

PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË AGJENCISË SHTETËRORE PËR SHPRONËSIMIN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të kreut III, të vendimit nr. 395, datë 13.5.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Erlis Hereni emërohet drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 861, datë 4.11.2020

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT NGA KATEGORIA E RESURSIT "TOKË BUJQËSORE" NË "TOKË URBANE", TRUALL, TË NJË SIPËRFAQEJE, NË PASURINË ME NUMËR 760, ZONA KADASTRALE 3694, BASHKIA BULQIZË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5/2, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e

strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, për sipërfaqen prej 1200 (një mijë e dyqind) m^2, pjesë e pasurisë me numër 760, zona kadastrale 3694, Bashkia Bulqizë, sipas certifikatës së pasurisë, hartës treguese dhe lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, qarku Dibër, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e resursit, nga "tokë bujqësore" në "tokë urbane", për sipërfaqen ndërtimore, sipas lidhjes nr. 1, të pasurisë me numër 760, zona kadastrale 3694, Bashkia Bulqizë.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Qarkut Dibër dhe Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Bulqizë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe




MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISE SELENICE
z. LEFTER ALLA
Lefter
Alla
DREJTORI I URBANISTIKES
Ing.ERJON ISAKU
PLANI I NDAJES SE PRONES QE ZHVILLOHET PER STRUKTUREN
"MAGAZINE RUAJTJE I BAT ME PODIUM PER BIME MEDICINALE"
INVESTITOR: "LO-AM MEDICINE"
SH 1:2000
SH 1:750
VENDOSJA E PRONES SIPAS
HARTES KADASTRALE SH.1:2000
VENDOSJA E PRONES SIPAS
ORTOFOTOS SH.1:2000
VENDOSJA E PRONES
SIPAS ASNG SH.1:2000
PERGATITI
SHQIPERIA ASNJA QC shpk
z. Andrii GJIKONDAJ
POROSITI
"LO-AM MEDICINE"
z. Dalion VOCI
Asnje

Digitally signed by Faik Balla
A. SH. ENGINEERING
Date: 2019.11.20 18:12:34 +01'00'

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË 1648332
PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. BULQIZË Zona Kadastrale Nr. 3694
Numri i Pasurisë 760 Volumi 4 Faqe 43
Adresa e Pasurisë VAJKAL
Lloji i Pasurisë ARE
Sipërfaqja Totale 3700.00 m2
Nga kjo : Sa Truall - Nga kjo : Sa Ndërtesa -
Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
DRILON	ISUF	VOCI	1/1	BULQIZE

- është pronar i pasurisë me numër 760
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi
- kufizimet e pasurisë janë : V 766 , L 763 , J — , P 759

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Data e lëshimit të çertifikatës
15/11/2019

Kjo certifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 12/11/2019 **Nr.** 1208

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUES
(ALBJON GJIMI)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SHTETËRORE E KADASTRËS ZYRA VENDORE BULQIZË

D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE, SERVITURAVE DHE INTERESAVE TE TJERA

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME BULQIZË
Adresa: Rruga 11 Nentori,Lagj. Brigada 17 S (prane Prefektures)
BULQIZË, me 15 11 2019

SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tone
Në regjistrin Vol 4, Faqe 43, Zona Kadastrale 3694, Qyteti Bulqizë

REGJISTRUESI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - ZYRA VENDORE BULQIZË - AGJENCIA SHTETERORE E KADASTRËS

Lidhja nr. 1

Nr. rendor	Qarku	Bashkia	Zona kadastrale	Adresa e pasurisë	Numri i pasurisë	Sipërfaqja m²	Sipërfaqja ndërtimore m²	Emërtimi i strukturës
1	Dibër	Bulqize	3694	Vajkal	760	3700	1200	Magazinë bujqësore 1-katëshe me podrum për bimë medicinale.

URDHËR
Nr. 318, datë 2.11.2020

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,; të nenit 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", të nenit 5, të ligjit nr. 8038, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009, "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 343, datë 21.7.1999, "Për krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), për:

- ngritjen e komisionit të vlerësimit dhe ndjekjen e procedurave për përzgjedhjen me konkurs të hapur të subjekteve që operojnë në linja të rregullta ndërqytetase udhëtarësh;
- nënshkrimin e licencave dhe të certifikatave të operimit, për transportin ndërqytetas të udhëtarëve;
- nënshkrimin e certifikatave për transport ndërkombëtar dhe të brendshëm të rastit.

2. Delegimin e kompetencës DPSHTRR-së për ngritjen e komisionit për shqyrtimin e aplikimeve dhe marrjen e vendimeve për miratimin e licencave nëpërmjet QKB-së, në veprimtarinë e nënkategorisë VII.7.1, "Transport rrugor ndërkombëtar i udhëtarëve".

3. Në ushtrimin e kësaj kompetence, DPSHTRR-ja të zbatojë kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 538, datë 26.5.2009, "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar; në udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016, "Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit", të ndryshuar, si dhe në udhëzimin nr. 15, datë 24.7.2007, "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor", të ndryshuar.

4. Ngarkohet DPSHTRR-ja për zbatimin e këtij urdhri dhe koordinimin me QKB-në për zbatimin e procesit.

5. Urdhri i ministrit nr. 667, datë 4.10.2018, "Për delegimin e kompetencave", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2020 - Numri: 193
Datë: 2020/11/09 15:04:24
e4480307-eaaf-4d1d-bbd8-911b8591aab1

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 420 lekë